



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i New York Tiranë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



1. Prof. Dr. Ermira Qosja
2. Prof. Dr. Klodiana Gorica

Korrik/2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Unversiteti New York Tiranë"

Nr.		
1	IAL aplikues:	UNYT
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 255, 27.02.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASH nr. 618, datë 26.12.2011
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	MAS nr.184, dt. 16.05.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA nr.73 datë 04.10.2019.
8	Cikli i studimit:	Master i Shkencave
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	PAE/PAK 85/15 (%) 2022-2023 - PAE/PAK 75/25 (%)
18	Numri i studentëve:	2019-2020 - 25 2020-2021 - 19 2021-2022 - 15 2022-2023 - 11
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Universiteti i New York-ut në Tiranë është universiteti i parë privat në Shqipëri, i licensuar në 15 Gusht 2002 me VKM Nr 397, i akredituar disa herë institucionalisht, riakreditimi i fundit institucional është më 18 Dhjetor 2020, me vendimi BA Nr. 61.

UNYT ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, me adresë qendrore Rruga “Kodra e Diellit”, në shtator të 2023 do të zhvendoset në një adresë të re, shumë pranë qendrës së Tiranës.

Sipas strukturës së UNYT, të miratuar në vitin 2017, aktualisht ky universitet përbëhet nga tre fakultete:

- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
- Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit
- Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore

Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, njësia kryesore që ofron programin e studimit “Programi Master i Shkencave” në “Administrim Biznes” me 6 profile, ka në përbërje të tij:

- Departamentin e Administrim Biznesit
- Departamenti e Ekonomi-Financës
- Departamentin e Informatikës së Biznesit.

Programi Master i Shkencave në Administrim Biznes, që ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit, është licensuar fillimisht me VKM 255, 27.02.2008, më pas përshtatur me ndryshimet ligjore në 2011 UMASH Nr. 618, ka kaluar një sërë akreditimesh dhe akredituar për herë të fundit në 2019, Vendimi Nr. 73. Programi ka 120 ECTS, zhvillohet në 5 semestra, përfshirë këtu dhe detyrimet përmblyesë diplomë e praktikë profesionale. Gjithsej zhvillohen 16 lëndë me 6 ECTS secila. Praktika është konceptuar si punë për përgatitjen e diplomës, pjesën e kërkimit primar. Për vitin e ardhshëm akademik do të bëhen disa ndryshime në program në masën 20%, të cilat janë miratuar.

Programi Master i Shkencave në Administrim Biznes, ofrohet në 6 profile: *a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë.* Numri i studentëve në këtë program është i vogël dhe ajo që duhet theksuar është që numri është në rënie (në përputhje me tendencën dhe në universitete të tjera, publike dhe private). Programi MSH në AB ofrohet në gjuhën angleze, duke përbërë një pikë të fortë për studentët, një mundësi për të patur studentë ndërkombëtarë, por dhe një barrierë në kushtet e një tregu të arsimit të lartë me shumë dilema, për shkak të zhvillimeve ekonomike dhe sociale në vend. Departamenti i Administrim Biznesit, që ofron programin plotëson kriteret ligjore të numrit dhe gradës së pedagogëve.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)


ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Ermira Qosja dhe Prof. Dr. Klodiana Gorica. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznes”, i ofruar nga Departamenti i Administrim Biznesit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit pranë UNYT, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në UNYT, u realizua në datën 19 dhe 20 Qershor 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në UNYT, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit të Administrim Biznesit dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Rektorin, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Ndërkombëtarizmit dhe Projekteve; Zyrës për Çështjet Studentore; si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit MSHAB, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse.

Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr., 73 dt. 4.10.2019 janë:

1. Rekrutimi i stafit të ri me grada dhe tituj, me qëllim që lëndët të mbulohen nga pedagogë me tituj e grada në përputhje me ligjet në fuqi, dhe uljen e ngarkesës mësimore
2. Të përcaktojë titullarë modulesh të kategorisë “Profesor”, në përpmbushje të kritereve të ligjit 80/2015.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni



1. Ka një përmirësim të dukshëm në angazhimin e pedagogëve të kategorisë profesor në vitet e fundit në programin e studimit MASH AB. Në se do t’i referohemi Tab.2 të dokumentit 2.1 në portal faqja 10, nga 16 pedagogë të angazhuar në mësimdhënien në master të shkencave për vitin 2022-2023, 6 prej tyre janë të kategorisë profesor. Gjithashtu, vlen të theksohet angazhimi i disa personaliteteve nga industria me eksperiencë shumë profesionale në disa fusha dhe lëndë në zhvillim.
2. Në lidhje me rekrutimin në Departament, mendojmë që ka akoma hapësirë për punësim të pedagogëve me tituj, ndonëse mirëkuptojmë barrierën për shkak të mësimdhënies në anglisht. Përsa i përket numrit të lëndëve që pedagogët mbulojnë, do ishte pozitive një ofertë më e diversifikuar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë" në "UNYT"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT



Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit të UNYT janë të lidhura me promovimin e vlerave kombëtare përmes ofrimit të edukimit dhe arsimit cilësor nëpërmjet krijimit të kushteve dhe mundësive për zhvillimin dhe aplikimin e njohurive të marra në mënyrë profesionale, e duke synuar krijimin dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Sipas Statutit të UNYT "Misioni i UNYT është përgatitja e qytetarëve dhe profesionistëve të ardhshëm nëpërmjet mësimdhënies, të të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe influencës në komunitet, duke siguruar njohuritë, aftësitë, moralin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar". <i>Annex 1.6_ Strategic Plan</i> <i>Annex 1.9_ Department Rules and Regulations</i> <i>Annex 1.10_ Program Rules and Regulations and Student Handbook</i> <i>Annex 1.1_ Statute</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi Master i Shkencave në Administrim Biznesi (ekuivalent me "Master i Shkencave") fillimisht u liçensua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 256 (27.02.2008) dhe më pas u ristrukturua për t'iu përshtatur kërkesave të një programi Master Shkencor në lidhje me numrin e krediteve duke u miratua nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ky program është ri-akredituar me Urdhërin nr. 73 / 04.10.2019 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. <i>[https://unyt.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/2019-Certifikate-VBA-Nr.73 -dt.04.10.2019-Akreditimi-i-prog-MSc-ne-Administrim-Biznesi-me-6-profile.pdf], (Shtojca A dhe B e Aneksit 1.10).</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje	Programi ka adresuar dhe adreson nevojat e tregut në funksion të plotë me prioritetet kombëtare strategjike si ato të parashtruara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030. https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim (https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/538)

<p>me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi Master në Administrim Biznes me 6 profile është në përputhje të plotë me interesin kombëtar për një kapital njerëzor konkurrues me rajonin, duke e bërë ofertën e punës në Shqipëri më tërheqëse për investitorët e huaj dhe lokalë.</p> <p>Ky program ka objektiva të përcaktuara qartë të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe karakterizojnë profilin e programit. Të gjithë programet e studimit konceptohen dhe hartohen në bazë të misionit të UNYT të shprehur në Statutin (<i>neni 3</i>) dhe Rregulloren e UNYT, pas një studimi të nevojave të tregut dhe të perspektivave ekonomike të vendit sipas strategjise së kerkimit në fuqi dhe Studimit të Tregut të vitit 2020. Misioni i UNYT është t'u ofrojë studentëve mundësinë për të fituar një diplomë universitare në nivelin Master në një numër specializimesh akademike dhe profesionale, e cila do t'u japë atyre njohuritë, aftësitë dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis pune të ndryshëm kombëtar ose ndërkombëtar dhe t'i përgatisë ata për jetën si qytetarë të aftë të komunitetit botëror.</p> <p><i>Annex 1.6_ Strategic Plan</i> <i>Annex 1.1_ Statute</i> <i>Annex 1.7_ UNYT Rules and Regulations</i> <i>Annex 1.10_ Program Rules and Regulation and Student Handbook</i> <i>Annex 2.3_ Master Thesis Guideline</i> <i>Annex 2.18.1_ Thesis Evaluation Form</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programet e studimeve të ofruara në UNYT janë në përputhje me planin strategjik për zhvillim të UNYT dhe synojnë pajisjen e studentëve jo vetëm me njohuritë bazë por edhe formimin e shprehive profesionale si edhe metodat shkencore të përgjithshme</p> <p>Plani Strategjik i Institucionit është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e UNYT. Në planin Strategjik 2020-2025, përcaktohen qëllimet e UNYT-së, si dhe veprimet dhe mjetet të për të arritur rezultatet e pritshme drejt përmbushjes së këtyre synimeve. Në krye të misionit dhe objektivave të UNYT-së qëndrojnë programet e tij të studimit, promovimi i metodave inovative të mësimdhënies dhe të nxënimit me fokus studentin, inkurajimi i studentëve për aktivitete sociale në të gjithë Unionin Studentor dhe klubet studentore, si dhe vlerësimi i ndërkombëtarizimit si pjesë strategjike e tij. Këto aspekte u ofrojnë studentëve një avantazh në fuqizimin e udhëtimit të tyre profesional, vizionin e tyre dhe njohjen e mundësive dhe sfidave globale në tregun e punës si dhe në kërkimin shkencor..</p> <p><i>Annex 1.6_ Strategic Plan</i> <i>Annex 1.1_ Statute</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master në Administrim Biznesi me 6 profile është konceptuar për t'iu përgjigjur kërkeses në zgjerim të tregut vendas dhe rajonal. Programi është i organizuar në përputhje me dispozitat ligjore të</i></p>






	<i>Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore dhe Statutit të Universitetit në lidhje me studimet e ciklit të dytë. Te gjitha dokumentat strategjike te institucionit, fakultetit dhe njesise baze qe e ofron kete program studimi jane ne te njejtin qellim dhe mision, ate te mbeshtetjes se dijes dhe njohurive qe percillen tek studentet permes realizimit dhe permbushjes se objektivave perkatese. Institucioni permbush plotesisht te gjitha kushtet dhe infrastrukturen perkatese per te ofruar kete program studimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>UNYT ka mbi dy dekada tashme që ka treguar koherencën dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të programeve cilësore të studimit. Ky program studimi është një certifikim i sigurisë së këtij institucioni në rrugën e dijes. Një tregues cilësor është edhe koherenca e vetë stafit, ku një pjesë e konsiderueshme e stafit mësimdhënës në këtë program studimi ka mbi 1 dekadë mësimdhënie në këtë institucion. Kapacitetet infrastrukturore dhe mbajtëse, sallat e leksioneve dhe seminareve, qendrat mbështetëse jo akademike, biblioteka cilësore reflektojnë mbështetjen akademike dhe jo akademike që i bëhet nga UNYT këtij program studimi.</p> <p>Stafi akademik i departamentit Administrim Biznesi përfshin lektorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë me një përvojë të gjatë e të suksesshme në akademi dhe në industri në profilet Administrim Biznesi, Menaxhim, Ekonomi Biznesi dhe Marketing.</p> <p>Infrastruktura e UNYT përfshin 2 kampuse universitarë me mjedise për studentët, si auditorë dhe klasa për leksione dhe seminare, laboratorë për praktika profesionale, bibliotekë dhe mjedise të librarisë dhe fotokopjes, Qendra të Këshillimit të Studentëve, mjedise sociale dhe sportive, mjedise për stafin (zyrat, sallat e mbledhjes, sallat e konferencave, mjedise për personelin mbështetës, mjedise çlodhëse, etj.</p> <p><i>Annex 1.7_UNYT Rules and Regulation</i> <i>Annex 1.8_Faculty Rules and Regulation</i> <i>Annex 2.1 (Tabela 2) Academic Staff in DBA</i> <i>Annex 2.1.1_Academic Staff CV</i> <i>Annex 4.1.2_Emerald Insight_service contract</i> <i>Annex 4.13_Library Facilities</i> <i>Annex 4.9_Library Policy and Procedures</i></p>

	<i>Annex 1.22 Proposal on MBA Curricula Revision</i>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Administrimit të Biznesit. Programi ofrohet nga rreth 16 staf akademik, të gjithë me tituj profesor, profesor të asociuar dhe doktorë shkencash, anëtarë të tre departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit: Departamentit të Administrimit të Biznesit, Departamentit të Ekonomi Financës dhe Departamentit të Informatikës së Biznesit.</p> <p>Programi i Masterit në Administrim Biznesi ofrohet si program studimi nga Departamenti i Administrimit të Biznesit, njësia bazë që ofron edhe programin bachelor në Administrim Biznesi me katër profile: Administrim Biznesi, Menaxhim, Marketing dhe Biznes Ekonomiks.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit. Përputhshmëria e programit të studimit me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit është bërë e mundur nga kodifikimi i programeve të studimit dhe lëndëve sipas profileve.</p> <p>UNYT ka krijuar këtë Program të Ciklit të Dytë të Studimeve në përputhje të plotë me nenin 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me aktet nënligjore, Statutin e UNYT, neni 5 & 7 dhe Planin Strategjik të UNYT.</p> <p>Programi respekton gjithashtu legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë duke ofruar ekuivalencën e 120 ECTS, për një periudhë prej dy vitesh akademike.</p> <p><i>Annex 1.7_UNYT Rules and Regulations</i> <i>Annex 1.9_Department Rules and Regulations</i> <i>Annex 1.10_Program Rules and Regulation and Student Handbook</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit për karrierë që i ndihmon ata të lokalizohen dhe të transferohen lehtësisht në tregun e punës. Zyra e Karrierës dhe Alumni (Të diplomuarit) i UNYT-së kontakton me komunitetet e biznesit në Shqipëri dhe rajon.</p> <p>Panairi i Karrierës i organizuar në Universitet çdo pranverë synon të ofrojë mundësi praktike dhe punësimi për studentët dhe ish-studentët e UNYT-</p>

	<p>së, duke u mundësuar atyre të marrin vendime të informuara mbi bazën e zhvillimeve socio-ekonomike kombëtare dhe rajonale.</p> <p>Zyra e Karrierës vazhdimisht organizon workshop/trajnime me qëllim përgatitjen e studentëve për pjesëmarrje në Panairin e Karrierës.</p> <p>Një listë e marrëveshjeve të vazhdueshme ndërmjet bizneseve/institucioneve dhe zyrës së karrierës së Universitetit jepet në <i>Anekset 5.1 dhe 5.17, Kapitulli 51.</i></p> <p><i>Annex 5.13_Career Centre workshop</i></p> <p><i>Annex 5.13.1_Career Fair Preparation Workshop 2020</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit. Përputhshmëria e programit të studimit me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit është bërë e mundur nga kodifikimi i programeve të studimit dhe lëndëve sipas profileve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3	<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UNYT ka ngritur një strukturë organizative që siguron marrëdhënie frytdhënëse bashkëpunimi midis njësive përbërëse. Struktura organizative lejon që të bëhet një ndarje e qartë e detyrave dhe e përgjegjësive për çdo fakultet dhe department. Kjo bën të mundur që çdo program të plotësojë objektivat dhe të ruajë cilësinë për të cilën është krijuar.</p> <p>Drejtuksi i departamentit mbikëqyr veprimtarinë dhe zhvillimin e departamentit duke u bazuar në planin strategjik të njësisë kryesore. Ai/Ajo zhvillon dhe menaxhon instrumentet e konsultimit, vendim-marrjes dhe komunikimit me stafin të njësisë, dhe siguron që detyrat akademike dhe administrative të departamentit të shpërndahen në mënyrë të drejtë për të mundësuar zhvillimin e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve (<i>Shih 1. Neni 24</i>).</p> <p>Autoriteti menaxhues i Fakultetit është Dekani i cili mbikëqyr koordinimin e aktiviteteve dhe programeve akademike të njësive bazë duke vlerësuar dhe rishikuar kurrikulën e Fakultetit, në përputhje me</p>			

¹ Një përshkrim më i detajuar i rolit ndërmjetësues të Universitetit në mes studentëve dhe bizneseve dhe organizatave të punëdhënësve është dhënë në Kapitullin V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

	<p>nevojat e tregut dhe standardet e programeve të akredituara. Dekani, duke u mbështetur mbi propozimet akademike të njëjse bazë për të siguruar edhe financim të jashtëm për projekte të veçanta paraqet nevojat buxhetore të Fakultetit.</p> <p>Në UNYT, departamentet/njësitë bazë bëjnë propozime në fillim ose në fund të vitit akademik në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe çështjeve të tjera që lidhen me departamentin dhe i përcjell ato tek Dekani i Fakultetit i cili më pas ia paraqet propozimin Rektoratit.</p> <p><i>Annex 1.1_ Statute</i> <i>Annex 1.15_ E-mail Communications announcing Online Learning during the Covid-19 Pandemic</i> <i>Annex 2.15_ Annual Monitoring Report 2020-2021</i> <i>Annex 2.15.1_ Annual Monitoring Report 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Sipas Planit Strategjik 2020-2025, UNYT e cilëson ndërkombëtarizimin si një komponent qendror të zhvillimit dhe misionit të tij të përgjithshëm strategjik,</p> <p>Në këtë kuadër UNYT ofron dhe programe bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë. Këto bashkëpunime janë kryer edhe në kuadër të ofrimit të mobiliteteve nëpërmjet programeve Erasmus.</p> <p>Gjithashtu, procesi i mësimdhënies ofrohet në gjuhën angleze dhe përmes një fondi librash të viteve të fundit po në këtë gjuhë.</p> <p>UNYT, që nga viti 2018 është pjesë e shkollave ndërkombëtare të rrjetit MAARIF, në 67 shtete të ndryshme, me 340 institucione edukimi www.ghmaarifschools.org</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Bashkëpunimi dhe partneriteti me universitetet e tjera si dhe organizatat publike e jopublike ka qenë dhe është një nga prioritetet e UNYT. Duke qenë një universitet i cili ka studentë dhe nga kombësi të ndryshme, qëllimi i UNYT ndër vite ka qenë konsolidimi dhe zgjerimi i një rrjeti partneritetesh dhe marrëdhëniesh bashkëpunimi për arsye edukimi, shkëmbimi ndërkombëtar për studentët, stafin akademik e administrativ, realizimin e praktikave si dhe punësimin e studentëve. Sot UNYT ka marrëdhënie bashkëpunimi me mbi 40 institucione homologe.</p> <p>Kurrikula e hartuar për programin e studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi me gjashtë profile, “Administrim Biznesi”, “Menaxhim”, “Marketing”, “Profil i Përgjithshëm”, “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” dhe “Bankë” është miratuar në kuadër të akreditimit periodik me Urdhrin nr. 73, datë 04.10.2019 të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse</p>	<p>Zyra e Karrierës është në kontakt të vazhdueshëm me institucione/kompani publike/jopublike dhe ka nënshkruar një numër</p>

<p>për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Marrëveshjes Bashkëpunimi për t'i shërbyer të gjitha programeve të studimit në UNYT.</p> <p>Gjithashtu UNYT ka zhvilluar, sesione akademike, konferenca shkencore ndërkombëtare, trajnime, seminare, diskutime, etj në bashkëpunim me ekspertë të fushës dhe institucione të tjera, duke marrë parasysh interesat e studentëve dhe integrimin e tyre në tregun e punës lokal dhe ndërkombëtar.</p> <p>Në funksion të analizës mbi performancën e stafit akademik, analizohet edhe përmbushja e objektivave të programit si dhe në lidhje me përfitimet që rrjedhin gjatë trajnimeve profesionale dhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projekteve ndërkombëtare dhe kombëtare. Në raport përfshihet analiza e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit, dhe veçanërisht pjesëmarrja e stafit akademik në programet e shkëmbimit dhe trajnimet në metodat e mësimdhënies.</p> <p><i>Annex 5.14_e-Career Fair 2020</i> <i>Annex 5.14.1_Online Career Fair</i> <i>Annex 5.14.2_Participation of the companies</i> <i>Annex 5.1_List of MoU</i> <i>Annex 5.14.3_Keynote Speaker Career Fair</i> <i>Annex 5.14.4_Invited Companies in Career Fair</i> <i>Annex 5.14.5_Career Fair Main Poster Social Media</i> <i>Annex 5.14.6_Photos From Career Fair</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në funksion të analizës mbi performancën e stafit akademik, analizohet edhe përmbushja e objektivave të programit si dhe në lidhje me përfitimet që rrjedhin gjatë trajnimeve profesionale dhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projekteve ndërkombëtare dhe kombëtare. Analizohen marrëdhëniet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe analizohen raporte vjetore analitike që përfshijnë njesinë baze, kryesore dhe deri në rektorat.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi respekton legjislacionin kombëtar dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë duke ofruar ekuivalencën e 120 ECTS, për një periudhë prej dy vitesh akademike.</p> <p>Ky program studimi është reflektim i një testimi që është bërë në treg ndër vite, duke u përballur me kërkesat e tregut, me bizneset, me alumni dhe studentët aktualë, duke u përpjekur për një reflektim cilësor teksa perpiqet të mbajë në nivele të larta emrin e mirë dhe konkurrueshmërinë që e ka karakterizuar. Plani mësimor i ka të gjithë elementët që duhet të përmbajë. Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p><i>Annex 1.4_VKM no.185 date 25.03.2021 ndryshimi i VKM 41. mbi elementet e programeve</i></p> <p><i>Annex 1.5_Teaching Plan</i></p> <p><i>Annex 1.10_Program Rules and Regulations and Student Handbook</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi MBA (ekuivalent i “Masterit të Shkencave”) u liçensua fillimisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 255 (27.02.2008) dhe më pas u ristrukturuar për t’u përshtatur kërkesave të një programi Masteri Shkencor të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ky program u akreditua me Urdhërin Nr. 161/ 18.03.2010 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, u riakreditua me Urdhërin Nr. Prot. No.384/ 06.09.2013, dhe u riakreditua sërish me Urdhërin nr. 73/ 04.10.2019 me gjashtë profile si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtim i Pergjithshëm 2. Menaxhim i Burimeve Njerëzore 3. Marketing 4. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit 5. Bankë 6. Menaxhim <p>Profilizimi, mësimdhënia në gjuhën angleze, qasja me tregun janë disa nga elementët që sigurojnë se janë transmetuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e duhura të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme.</p> <p><i>Annex 1.5_Teaching Plan</i></p> <p><i>Informacion mbi programin Masteri Shkencor ne Administrim Biznesi</i> https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/master-of-science-in-business-administration-mba/#The-Programme</p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi përmban 16 klasa në total, secila prej 6 kreditesh dhe teza e masterit prej 30 kreditesh. Ai ofrohet në tre semestra që përbëhen nga 18 ECTS secila, një semester i katër i cili fokusohet në klasat e profilit me përbërje 24 ECTS dhe një semester i pestë, i cili fokusohet në përgatitjen e tezës, prej 42 ECTS. Programi ofrohet në gjuhën angleze. Lëndët ofrohen në sesione fundjavore një here në dy javë, ku çdo sesion përmban 20 orë. Çdo lëndë zgjat dy fundjava me 40 orë në total, plus pesë orë provim.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ 1 vit akademik është ekuivalent me 30 javë mësimore në auditor ➤ 1 ECTS është i barabartë me 25 orë punë e studentit ➤ 1 orë mësimore është 50 minuta <p>Raporti i orëve me kredite, shpërndarja e krediteve sipas lëndëve brenda programit të studimit është në përputhje me ligjin dhe në mbështetje të përmbylljes së detyrimeve përkatëse të këtij programi studimi.</p> <p><i>Annex 1.2_Curricula - MSc. In Business Administration</i> <i>Annex 1.7_UNYT Rules and Regulations</i> <i>Annex 1.10_Program Rules and Regulations and Student Handbook</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin</p>	<p>NA</p>





ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.									
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	NA								
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Shoqërizimi i këtij program studimi me kodin përkatës është kryer sipas fushës përkatëse të studimit dhe klasifikimeve të shpallura nga ministria e arsimit dhe e sportit. Kështu, bazuar në Udhëzimin Nr. 31. 15. 01. 2022, për “Proçedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktimi i kodeve është hartuar duke konsideruar elementët e studimit të mëposhtëm: a) Nivelin e programit të studimit, sipas nivelit të përcaktuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit; b) Kohëzgjatjen e programit të studimit; c) Llojin e programit të studimit; d) Fushën e detajuar në të cilën bën pjesë programi i studimit; e) Gjuhën e programit të studimit. Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit është kryer kodifikimi i programeve dhe i lëndëve të programeve. <i>Annex-1.11] Program Coding Prot. No. 55</i>								
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA								
Konkluzione	<i>Profilizimi, mesimdhënia në gjuhën angleze, qasja me tregun janë disa nga elementë që sigurojnë se janë transmetuar njohuritë aftësitë dhe kompetencat e duhura të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), po kështu njohuritë dhe aftësitë janë organizuar sipas lendeve dhe moduleve të organizuara në kredite, të shpërndara në semestra dhe 2 vite akademike.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Programi Master në Administrim Biznesi me profilet përkatëse ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit, pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit. Departamenti i Administrimit të Biznesit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, është e pajisur me staf akademik për të plotësuar nevojat e programit.</p> <p>Keshtu, një është profesor, katër janë doktorë shkencash dhe dy kandidat kandidate Departamenti i Ekonomisë dhe Financës së bashku me Departamentin e Informatikës së Biznesit ofrojnë stafi akademik për kurse që lidhen me qëllimin e profilit të tyre.</p> <p>Gjithashtu për të mbështetur procesin e mësimdhënies por edhe diversifikuar ofertën akademike, njësi bazë mbështetet edhe në lektorë të jashtëm apo guest speaker. Përveç kësaj, stafi akademik me kohë të pjesshme: tre profesorë, pesë doktorë shkencash dhe një me master shkencor është gjithashtu i angazhuar në departament për të siguruar dhe përcjellë një vlerë të shtuar sipas përvojës së tyre akademike në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe përvojës së tyre të vlefshme në industri.</p> <p>Nga ana tjetër, vlen për t'u theksuar dhe shtuar si vlerë stafi ndihmës akademik mbështetës i procesit të mësimdhënies por jo vetëm. Ekzistenca e të paktën 3 zyrave mbështetëse tek të cilat mund të shkojë dhe referohet studenti për çdo problem apo paqartësi të vetën tregon një përkushtim të UNYT ndaj këtij program studimi. Kjo mbështetje u identifikua qartë pothuajse në të gjitha takimet që u zhvilluan në institucion që nga ato me rektorin dhe zv rektoren, me stafet akademike apo me drejtuesit e njësive bazë dhe asaj kryesore, pra përkushtimi i kahershëm që UNYT demonstron dhe reflekton në tërësinë e organigramës së tij mbetet një faktor i rëndësishëm, strategjik dhe që identifikon lehtësisht.</p> <p><i>Annex 1.7_UNYT Rules and Regulations</i> <i>Annex 1.1.1_Organogram</i> <i>Annex 2.1 (Tabela 2) Academic Staff in DBA</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit është personi përgjegjës për mirëfunksionimin akademik të departamentit, duke iu referuar miratimit të planprogrameve së bashku me Dekanin sipas nenit 20 të Rregullores dhe Rregullores së Fakultetit (Shtojca 1.8).</p> <p>Njësia kryesore bazë mbështet përditshmërinë e aktiviteteve të veta në një staf cilësor administrative i cili përkujdeset për studentin që në hyrje dhe vijon t'a bëjë atë për çdo proces dhe kohë në vijim. Drejtuesi i Departamentit është personi përgjegjës për koordinimin e programit. Drejtuesi përgatit programin e lëndëve të ofruara dhe shpërndarjen e</p>

	<p>orëve mësimore për pedagogët e departamentit në bashkëpunim me Dekanin. Pra shpërndarja e orëve dhe e lëndëve bëhet në përputhje me natyrën e lëndëve, nevojat e departamentit dhe profilizimet e stafeve përkatëse, të jashtme dhe të brëndshëm.</p> <p><i>Annex 1.1_Statute</i> <i>Annex 1.8_Faculty Rules and Regulations</i> <i>Annex 2.5_ Communication on Research Proposal Status and Supervisor assigned</i></p>								
Konkluzione	<p><i>Departamenti është përgjegjës për programin e studimit që ofron dhe e rezlizon kete proces ne menyre te qarte dhe sistematike.</i></p> <p><i>Njësia bazë (departamenti) ka në përbërjen e saj të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si staf akademik, nga të cilët të paktën tre janë me grada shkencore ose tituj akademikë (Departamenti ka 16 përfaqësues akademikë, me kohë të plotë dhe të pjesshme, respektivisht, 4 Profesorë, 9 Lektorë/PhD dhe 3 Asistent Lektor/MSc).</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">x</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				x
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			x						

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi mundëson një eksplorim të thellë të faktorëve determinues të biznesit dhe ofron njohuri dhe aftësi për aplikimin e profesionit si dhe vazhdimin në ciklin e tretë të studimeve. Kjo bëhet përmes një kombinimi të lëndëve bazë dhe të profilit që përfshijnë leksione, sesione ndërvepruese përmes seminareve, aplikim të aftësive kërkimore dhe klasa për zgjidhjen e problemeve.</p> <p>Programi, sikurse parashtruar ne faqet 50-51 të RVB-së, zhvillohet gjatë një periudhë prej dy vitesh dhe organizohet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi bazë përgatitor, per studentët me studime bachelor të ndryshëm nga biznesi ofrohet gjatë fundjavave të nëntorit çdo vit. - Semestri i parë, për të gjithë studentët e MScBA fillon në dhjetor deri në shkurt ku ofrohen tre lëndë. - Semestri i dytë fillon në mars deri në maj, përsëri duke ofruar tre lëndë të tjera nga ketegoria e lëndëve themelore. - Semestri i tretë fillon në fund të majit deri në korrik ku ofrohen tre lëndët themelore të mbetura. - Semestri i katërt fillon në shtator deri në mes të dhjetorit, duke ofruar katër lëndët e profilit. - Semestri i pestë fillon në mes të dhjetorit deri në fund të qershorit gjatë të cilit ofrohen dy lëndët e tezës së masterit. Gjatë këtij semestri, studentët

	<p>gjithashtu punojnë në mënyrë të pavaruar për përfundimin e tezës së masterit.</p> <p>Fakulteti Ekonomise dhe Departamenti Administrim Bisnesit ka informacion të plotë për organizimin strukturën dhe përmbajtjen e studimeve. Keto dy njësi ruajne informacione të detajuara rreth planit mësimor të programit të studimit, shpërndarjes në module, kredite, dhe përmbajtjen e plotë të secilit prej moduleve. Këto informacione përditësohen në mënyrë periodike nëpërmjet procedurave të parashikuara në rregulloret.</p> <p>Ne planin mësimor përfshihen të gjithë elementët e rëndësishëm që përmban normalisht një plan mësimor që nga organizimi në kredite, shpërndarja e orëve mësimore, etj. Plani mësimor është i detajuar, jep shumë informacion, sqaron dhe orienton paqartësitë.</p> <p><i>Annex 1.2_Curricula - MSc. In Business Administration</i> <i>Annex 1.5_Teaching Plan UNYT</i> <i>Annex 2.1_(Tabela 10)_Teaching Plan</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bashkësia e dokumentacionit që shoqëron RVB është e plotë dhe cilësore, argumenton dhe mbështet kriteret përkatëse për certifikimin e këtij programi studimi dhe përfshin që nga rregullorja, planet mësimore, sillabuset, anekset me tabela të detajuara, etj. Në këto dokumenta përshkruhet se si studenti merr informacion për cdo element që nga kriteret e pranimit, mënyrat dhe mundësitë e transferimeve apo ekuivalentimet e programeve. Fakti i mësimit në anglisht përbën një mundësi atraktive për të tërhequr studentë që janë duke kryer studime paralele nga vende të tjera të zhvilluara dhe për t'i përfunduar ato në këtë program studimi të UNYT. Kjo përbën një mundësi që ky departament në targetat e vet të synyar të synojë mundësimin edhe të këtij segmenti tregu, i cili do të rrisë përveç sasisë edhe cilësinë e prurjeve, imazhin dhe shërbejë si një marketing i mirë për UNYT.</p> <p><i>Annex 1.10_UNYT Rules and Regulations and Student Handbook</i> <i>Annex 1.20_Transfer Credit Rregulation</i> <i>Annex 1.20.1_Sample of Transfer Form</i> <i>Annex 2.4.1_Induction Day ppt</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Departamenti garanton kapacitet të mjaftueshëm si në numër pedagogësh ashtu edhe në marrëdhëniet entitete publike e private për realizimin e formimit praktik të studentëve dhe plotesimin e të gjithë komponentëve formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>Syllabuset e moduleve/lëndëve përkatëse janë document i rëndësishëm që duhet normalisht të përmbajë të gjitha informacionet që studenti merr për lëndën që do të zhvillojë, por edhe një dokument i cili reflekton ndryshimet dhe përmirësimet dhe përbën kështu një mjet strategjik për të kontrolluar vijueshmërinë.</p> <p><i>Annex 2.2_Syllabi MScBA</i></p>

	<p><i>Annex 2.12_Sample Lesson Plan_Agenda Week I</i> <i>Annex 2.12.1_Sample Lesson Plan_Agenda Week II</i> <i>Annex 2.12.2_Sample Internal & External Communication- Course Syllabi & Lesson Plan</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Ky program studimi është objekti i diskutimeve për përmirësim të vazhduara. Kjo frymë u ndje shumë përgjatë vizitës në institucion si nga stafet e brendshme ashtu edhe nga zyrat që janë përgjegjëse për cilësinë, këshillimin apo karrierën, sikurse edhe në qëndër të diskutimeve në njësinë bazë që është kryesore për mbarrëvajtjen e këtij program. Në këtë diskutim janë të përfshirë njaftueshëm edhe studentët, opinionet e të cilëve tërhiqen dhe analizohen në departament.</p> <p>Njësia bazë, departamenti i administrim biznesit si përgjegjës për mbarrëvajtjen e këtij programi studimi bën përpjekje të vazhduara për të përmirësuar në aspekte të ndryshme kurrikulën e këtij programi. Kështu, në tetor të 2022 kjo njësi ka bërë një propozim që i paraprin këtij vlerësimi akreditimi të programit duke përqasur dhe përafuar ndryshimet e propozuara nga njësia me ato të GVJ.</p> <p>PROPOZIM PËR RISHIKIMIN E KURRIKULËS SË PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER SHKENCOR NË ADMINISTRIM BIZNES është dokumenti që shpjegon këtë procedurë dhe përmban argumentin dhe llojet e propozuara të ndryshimeve.</p> <p>Kështu, për një periudhë të gjatë departamenti ka identifikuar rëndësinë e reflektimit të disa ndryshimeve në kurrikul, të cilat janë diskutuar dhe ardhur në formën e një propozimi përmes një dokumenti që bashkangjitet dokumentacionin në sistemin elektronik të Ascal nga UNYT. Ndryshimet kurrikulare, nën 20%, në programin e Masterit Shkencor në Administrim Biznesi me gjashtë profile hyjnë në fuqi në vitin akademik 2023-2024 dhe konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Zëvendësimin e lëndës ‘Hyrje në Projektin e Tezës’ me lëndën ndërdisiplinare ‘Analitikë Biznesi’- Analitikë të Biznesit (Business Analytics) ofron spektrin e plotë të aftësive dhe dijes së nevojshme për të krijuar vlerë biznesi nga Big Data dhe burime të tjera të informacionit sasior ● Zëvendësimin e lëndës ‘Konferencë/Mbrojtja e Tezës’ me lëndën ndërdisiplinare ‘Sipërmarrje dhe Inovacion’- Sipërmarrje dhe Inovacion (Entrepreneurship and Innovation) ofron mendësinë e aftësitë sipërmarrëse në kohën kur kemi modele të reja të biznesit bashkëkohor që inxhinierohen nga procesi i pandalshëm i inovacionit. ● Zëvendësimin e lëndës ‘Menaxhimi i Inovacionit dhe Ndryshimit’ me lëndën e specialitetit ‘Marketing Dixhital’ për profilin Marketing- Marketing Dixhital (Digital Marketing) ka si qëllim të sigurojë të kuptuarit të peisazhit dixhital gjithnjë në evoluim me qëllim që t’i pajisë studentët me instrumentat e nevojshëm për të hartuar një strategji të marketingut dixhital.


	<ul style="list-style-type: none"> Riemërtimin e lëndës 'Menaxhimi Ndërkulturor' me lëndën e specialitetit 'Menaxhim Ndërkombëtar' për profilin Menaxhim-Menaxhim Ndërkombëtar (International Management) synon më mirë trajtimin e sfidave që bizneset hasin kur hyjnë në tregjet ndërkombëtare, mënyrave respektive të hyrjes dhe strategjive ndërkombëtare. Këto ndryshime u diskutuan edhe me drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore, u dakortësuan dhe erdhën natyrshe edhe nga stafi i brendshëm, dhe dakortësuan në një farë mënyre edhe me grupin e vlerësimit të jashtëm përgjatë vizitës në institucion. Annex 2.2_Syllabi MScBA Annex 2.12.2_Sample Internal & External Communication- Course Syllabi & Lesson Plan Anex 1.22 Propozim per ndryshim te kurrikules MBA 		
Konkluzione	<p>Programi i studimit është objekt rishikimi dhe diskutimi periodik midis stafit dhe brenda departamentit. Kështu, departamenti ka propozuar një ndryshim që përfshin përfshirjen e disa moduleve të rëndësishme në vend të disa të tjerave sikurse edhe riemërtime të lendeve. Këto ndryshime janë të argumentuara dhe synojnë reflektimin e nevojës së re të tregut në këto kurrikul.</p> <p>Plani mesimor përmban të gjithë elementet e nevojshme dhe të detajuar si për komponentet e planit mesimor ashtu edhe për informacionet për studentet që nga transferimet, kreditet, etj. Për këto shërbejnë dhe zyrat mbështetëse ku student lehtësisht merr informacion në mënyrë të plotë dhe graduale që në fillim të hyrjes së tij në këtë program studimi.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të nxënies, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Kurrikula e hartuar për programin e studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi me gjashtë profile, 'Administrim Biznesi', 'Menaxhim', 'Marketing', 'Profil i Përgjithshëm', 'Menaxhimi i Burimeve Njerëzore' dhe 'Bankë' është miratuar në kuadër të akreditimit periodik me Urdhrin nr. 73, datë 04.10.2019 të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.</p> <p>Veprimtari formuese për secilin profil në funksion të thellimit të njohurive dhe të aftësive, janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Lëndë Bazë (A)- 5% Lëndë Karakterizuese (B)- 60% Lëndë Ndërdisciplinore (C)- 10%


	<ul style="list-style-type: none"> • Lëndë Plotësuese (D)- 10% • Teza e Diplomës (E)- 15% <p>Klasat ofrohen një çdo fundjavë me 20 orë. Çdo kurs zgjat dy fundjava prej 40 orësh në total. Në këtë mënyrë programi ofron një mundësi për studentët që punojnë për të avancuar njohuritë e tyre duke përparuar dhe ushqyer karrierën e tyre.</p> <p>Ky program studimi përbën një përpjekje cilësore për të vijuar dhe mbajtur në nivele konkurrueshmërie të lartë programin e dikurshëm të MBA të përshtatur tashmë në Master Shkencor, e cila për të vijuar këte do t'i duhet patjetër të zhvillojë një studim të thellur të tregut me qëllimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Testimit të reflektimeve aktuale në kurrikul; • Analizës dhe pararojës për ndryshime më cilësore në të ardhmen, duke e kthyer këtë program studimi në një mjet proaktiviteti për një qasje më cilësore ndaj tregut. <p><i>Annex 2.1 (Table 9) Formative Activities</i> <i>Annex 1.5 Teaching Plan</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Oferta akademike që përmban Departamenti i Administrim Bisnesit përfshin edhe këtë program studimi të ofruar me 6 profile, pikërisht për të plotësuar sa më mirë nevojat e tregut, për të rritur profilizimin, dhe për të diversifikuar aftësitë që formohen përmes profilizimit, duke rezultuar me një qasje më të afërt me tregun dhe mundësi punësimi për studentët. Gjithnjë UNYT ka qenë i kujdesshëm për të reflektuar mirë dhe cilësisht ndryshimet e tregut apo për t'a testuar sa më mirë tregun paraprakisht. Gjithgjasi sugjerohet një shportë për lëndë marketing me zgjedhje në rastin e përzgjedhjes së studentëve të profilit marketing, apo të një grupi lëndësh që lidhen me inovacionin dhe sipërmarrjen si në rastin e zgjedhjes së profilit të marketingut ashtu edhe të manaxhimit.</p> <p>Sigurisht që finalizimi i përzgjedhjes dhe përfshirjes së lëndës Marketing Digital është cilësor dhe duhet të kishte ardhur me kohë, por ndryshime të tjera cilësore do të jetë e nevojshme për të ardhmen, më shumë risi dhe lëndë inovative që lidhin sipërmarrjen me marketingun. Përderisa një pjesë e studentëve të bachelorit në administrim biznes ndjekin studimet master duhet të shikohen me kujdes që lëndë që janë në bachelor të mos përsëriten në master. Një rast i tillë i referohet faktit që në këtë program studimi nuk ka pse të jetë Drejtimi Marketing ndërkohë që është në nivelin bachelor për administrim biznesi. Fare mirë, në vend të tij mund të përfshihen lëndë nga shporta inovative të fushave të sipërmarrjes apo marketingut. Sugjerojmë përfshirjen e Marketingut Sipërmarrës mbase në të ardhmen, si një qasje aspak tradicionale e marketingut e aplikuar mirë dhe qartë nga sipërmarrjet e suksesshme në botë në kushtet e rallisë së burimeve dhe mungesës së avantazheve në treg, e përqasuar si nga start up, SME edhe nga bizneset e mëdha. Kjo mund të sugjerohet aq më shumë në sensin që ky master synon të bëjë një profilizim të thelluar. Këtë e lehtëson edhe fakti së student zgjedh lëndet/klasat core apo bazike dhe më</p>

	<p>tej 4 lëndë me zgjedhje. Përpjekja e finalizuar tashmë me një dokument që propozon dhe argumenton ndryshimet për vitin e ardhshëm akademik, brenda 20% sigurisht është cilësore dhe për t'u vlerësuar.</p> <p><i>Annex 1.2_Curricula - MSc. In Business Administration</i> <i>Anex 1.22 Propozim per ndryshim te kurrikules MBA</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> <p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në lidhje me pyetjen që iu bë nga GVJ për rritjen e efikasitetit ekonomike për këtë program studimi drejtuesi i njësisë kryesore përgjigjet se: <i>Njësisë kryesore është munduar të bëjë reflektimet e duhura pas akreditimit lidhur kryesisht me përmirësimet e prurjeve të stafit, që i referohet rritjes së stafit me grada shkencore që jep mësim në nivelin master. Eficenca është dicka që evoluon pasi duhet gjetur një balance e kujdesshme oferte akademike e cila të përmirësojë cilësinë teksa vendosë më tej nëse ka nevojë për rishikime dhe përmirësime të mëtejshme.</i></p> <p>Për shkak të koherencës së gjatë në treg programi master ka hapësirë dhe horizon të gjerë, të testuar tashmë dhe të kthyer në një histori suksesi. Duke qenë në formën e një programi MBA qasja që ka patur në treg ka rritur jo vetëm sigurinë e masterit por edhe konkurrueshmërinë në nivel universiteti edhe për shkak të këtij masteri.</p> <p>Por sigurisht numri i ulët i studentëve i identifikuar si një fenomen që po përballen të gjithë IAL shqiptare, përbën një sfidë edhe për këtë program studimi, me të cilën po përballen edhe UNYT dhe teksa po përpiqet për të gjetur zgjidhjet e veta.</p> <p><i>Annex 1.2_Curricula - MSc. In Business Administration</i> <i>Annex 2.16_Course schedule 2019-2021</i> <i>Annex 2.16.1_Course schedule 2020-2022</i> <i>Annex 2.16.2_Course schedule 2021-2023</i> <i>Annex 2.2_Syllabi</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nevojat e procesit mësimor dhe të studenteve me materiale didaktike janë të mbuluara mirë; me tekste, skripte, leksione, përmbledhje e prezantime, detyra, ushtrime, të dhëna e informacione të ndryshme, apo softë të nevojshme për studentët, të cilat janë të pasqyruara edhe në Web faqet personale të pedagogëve.</p> <p>Në lidhje me syllabuset në program Master, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u vu re se:</p> <p>a. Disa prej syllabuseve nuk kanë të unifikuarat format e vlerësimit. Brenda respektimit të lirisë akademike të cdo lektori që jep mësim në këtë nivel master sugjerohet që të kenë një uniformitet që të respektohet. Sigurisht që mund të ketë edhe devijime për shkak të natyrës së lëndëve në master, por në përgjithësi unifikimi i formës së vlerësimit duhet të bëhet dhe të jetë standarte.</p> <p>b. Për shkak se syllabuset nuk janë të detajuara në shtjellime të temave sipas VKM 41, rezulton që mungesa e këtij informacioni mund të rezultojë jo përfituese për studentët. Sugjerohet fort që sa më parë të përshtaten këto syllabuse me VKM 41</p>



	<p>c. të përfshihen brenda syllabuseve së bashku me temat përkatëse dhe literaturë për cdo temë edhe parashikimet për guest speaker, me qëllimin e rritjes së transparencës por edhe për t'i bërë me dije studentët për të gjithë planifikimin e semestrit. Në këtë mënyrë do të jenë të parashikuar në auditor apo edhe vizitat.</p> <p><i>Annex 2.2_Syllabi</i> <i>Annex 2.11_Developmental Workshop_Syllabus & Grading design</i> <i>Annex 4.1.6_McGraë-Hill Contract</i> <i>Annex 4.9_Library Policy and Procedures</i> <i>Annex 4.13_Library Facilitie</i></p>								
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi mundëson një eksplorim të thellë të faktorëve determinues të biznesit dhe ofron njohuri dhe aftësi adekuate për aplikimin e profesionit si dhe vazhdimin në ciklin e tretë të studimeve. Kjo bëhet përmes një kombinimi të lëndëve bazë dhe të profilit që përfshijnë leksione, sesione ndërvepruese përmes seminareve, aplikim të aftësive kërkimore dhe klasa për zgjidhjen e problemeve.</p> <p><i>Annex 1.2_Curricula - MSc. in Business Administration</i> <i>Annex 1.5_Teaching Plan</i></p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Në përfundim të këtyre programeve studentët do të zotërojnë kompetenca dhe kapacitete analitike të nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike në fushën e programit të ndjekur. Por edhe fakti që jepet mësimi në fundjavë mbështet punësimin e tyre, megjse nga studentet u konsiderua se UNYT duhet të ofrojë edhe alternativa të tjera ndjekjeje të këtij program studimi për ato studentë të cilët nuk mundën ta ndjekin në kushtet aktuale edhe për shkak të ngarkesës së madhe mësimore (orë mësimore) të përqëndruara në fundjave.</p> <p><i>Annex 1.1_Statute</i> <i>Annex 5.12.1_Open session - UNYT Career Fair</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Syllabuset përbëjnë elementë të rëndësishëm që reflektojnë dije dhe aftësi të transmetuara por edhe process mësimi dhe vlerësimi. Është e nevojshme që brenda tyre të unifikohen format e vlerësimit, të përshtaten sipas VKM 41. Përvec ndryshimeve të propozuara nga njësisia bazë departamenti të argumentuara dhe përfshira brenda 20%, sugjerohet që në të ardhmen më shumë lëndë të sipërmarrjes dhe marketingut të përfshihen qoftë edhe në kurrikulat bazë apo apo me zgjedhje për të rritur më shumë profilizimin dhe për t'a bërë sa më proaktiv këtë program studimi.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							



23



Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit</p>	<p>Gjatë kësaj periudhe 17 vjeçare stafit akademik i UNYT ka fituar përvojë te cmuar në procesin akademik të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, qe ka ndihmuar ne formimin e profesionistë të rinj me njohuri dhe aftesi te larta ne zhvillimin personal, intelektual dhe krijues të studentëve të tij. UNYT perfshin tre njësi thelbësore me qëllim që të ndihmojë studentët të nisin karrierën e tyre, përkatësisht Zyra e Alumni, Zyra e Karrierës, dhe Zyra për Çështjet Studentore. Këshilltari akademik i studentit dhe Zyra e Karrierës u ofrojnë studentëve dhe të diplomuarve udhëzimet dhe burimet që mund t'i ndihmojnë ata të planifikojnë më mirë karrierën e tyre të ardhshme.</p> <p>Departamenti i Administrimit të Biznesit është përgjegjës për ofrimin e programit master shkencor dhe per te testuar perputhjen e tij me kerkesat e tregut kryen anketën e daljes së studentëve pasi studentët diplomohen nga programi.</p> <p>Anketimi synon të mbledhë të dhëna nëse kurrikulat i kanë përmbushur synimt që studentët kanë pasur në fillim të programit dhe aftësitë e fituara përballë nevojave të industrisë.</p> <p>Vështrimet nga ky sondazh janë të dobishme për çdo rishikim dhe korigjim të kurrikulës për t'u përmirësuar. Të dhëna të tjera të vlefshme ofrohen nga folësit e ftuar që vizitojnë Universitetin tonë dhe përfaqësojnë modele të suksesshme biznesi.</p> <p>Nje nder diskutimet me eficente me studentet ka qene ne lidhje me permiresimin e planit mesimor per brezat e ardhshem qe do te ndjekin kete program studimi. Përfshirja e studenteve është e kahershme, shume zyra administrative dhe ndihmese akademike jane ne mbledhje te tyre dhe ne dhenie te informacionit qysh heret. Kjo është konsideruar si nje nder pikat e forta te UNYT. E ardhur kjo qasje edhe permes takimit ne institucion me studentet rezulton efecente pervecse ne dokumenta dhe letra.</p> <p>Departamenti mban kontakte me student të diplomuar jo vetëm nëmjet aktiviteteve të ndryshme si konferenca panairë pune etj, me qellim qe ata te japin drejtpërdrejt kontributin e tyre në përmirësimin e programit të studimit. Është praktike normale qe gjithnje studentët e diplomuar te ftohen që të japin eksperiencën dhe opinionin e tyre mbi programin e studimit.</p> <p>Madje si rezultat i ketij testimi vjen edhe propozimi nga vete departamenti per reflektim ne kurrikula ne masen 20% duke zevendesuar lende me lende te tjera apo ndryshuar emertim. Per shkak te koherences se gjate ne treg programi master ka hapësire dhe horizon te gjere, te testuar tashme dhe te kthyer ne nje histori suksesi. Duke qene ne formen e nje program i MBA qasja qe ka patur ne treg ka rritur jo vetem sigurine e masterit por edhe konkurrueshmerine ne nivel universiteti edhe per shkak te ketij masteri.</p>


	<p><i>Annex 1.1_Statute</i> <i>Annex 3.13_Exit Survey Questions MScBA</i> <i>Annex 5.14.3_Career Fair Agend; Keynote Speaker Career Fair</i> <i>Annex 5.14.4_List of the Invited Companies Career Fair</i> <i>Annex 5.14.5_Main Poster Social Media Career Fair</i> <i>Annex 5.14.6_Career Fair 2022</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Është një nga qëllimet kryesore të UNYT që të stimulojë kompetencat dhe aftësitë e studentëve nëpërmjet programeve akademike, prandaj e gjithë struktura (zyrat specifike, pedagogët, këshilltarët) dhe aktivitetet e ndërmarra u japin studentëve të gjitha aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'iu qasur me sukses në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Panairi i punes, qasja me bsinetin bashkëpunimi me institucione publike dhe private, perfshirja e guest speaker jane disa prej metodave permes se ciles njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme.</p> <p><i>Annex 4.1 Book Purchase Report 2020-2023</i> <i>Annex 2.1 (Tabela 5)_List of MoU_BA</i> <i>Annex 5.1_List of MoU</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentet dhe vjelja e informacionit nga studentet perben nje instrument eficient te rezultuar per cdo permiresim te mundeshem te kurrikules, te cilesise etj. Panairi i punes, qasja me bsinetin bashkëpunimi me institucione publike dhe private, perfshirja e guest speaker jane disa prej metodave permes se ciles njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjetërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>UNYT respekton dhe garanton lirinë akademike në mësimdhënie, mësimnxënie, kërkim shkencor dhe risi. Programi mundëson një eksplorim të thellë të faktorëve determinues të biznesit dhe ofron njohuri dhe aftësi adekuate për aplikimin e profesionit si dhe vazhdimin në ciklet e tjera te metejshme të studimeve. Kjo bëhet përmes një kombinimi të lëndëve bazë dhe të profilit që përfshijnë leksione, sesione ndërvepruese përmes seminareve, aplikim të aftësive kërkimore dhe klasa për zgjidhjen e problemeve. Programi është hartuar t'i pajisë studentët me njohuri të avancuara në tematika specifike në studimet e biznesit. Ndërsa nga një anë, programi synon të përmirësojë shprehitë praktike të zgjidhjes së problemeve të biznesit, nga ana tjetër programi synon të aftësojë studentët</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë</p>	

<p>kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>me njohuri të gjera e të thelluara teorike të tilla që të aftësojnë studentët në prirjen kërkimore dhe të ndjekin më tej studime doktorale.</p> <p>Programi mbështetet me një infrastrukturë të qëndrueshme dhe të pasur, të tilla si laboratorë, burime bibliotekare, software për analiza të të dhënave cilësore e sasiore etj.</p> <p>Së fundmi, si pjesë e cilësisë së mësimdhënies dhe kontrollit të saj, por e konsideruar edhe pjesë e këtij kriteri, vlen të theksohet përdorimi i një metrike të njohur si Raporti i Drejtësisë së Notave, Krahasueshmërisë dhe Auditimit të Transparencës, i cili përgatitet nga Përgjegjësi i Departamentit në lidhje me komponentin e mësimdhënies dhe të nxëniet për programet universitare, si dhe nga Drejtori i Programit për MScBA.</p> <p><i>Annex 3.12 Course Projections 2022-2023</i> <i>Annex 2.14 Grading Transparency and Comparability Report</i> <i>Annex 1.1 Statute</i> <i>Annex 1.6 Strategic Plan</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit është krijuar për t'i pajisur studentët me njohuri të avancuara në tema të specializuara në fushën e biznesit. Ndërsa synon të përmirësojë aftësitë praktike dhe të zgjidhjes së problemeve të biznesit, programi synon gjithashtu të ofrojë informacion teorik të gjerë e të mjaftueshëm, duke promovuar kërkimin shkencor, i cili ndihmon studentët e interesuar të ndjekin doktoraturën në përputhje të plotë me Statutin, Planin Strategjik, Rregulloren e UNYT dhe Udhëzimet për Tezat e Masterit. Ky motivim tek studentet kalon që nga diskutimi me rastet e studimit, projektet kërkimore brenda detyrimeve të secilës lëndë e deri tek diplomimi. Fakti që të gjithë studentët diplomohen, pra zgjidhet të bëjnë diplomë rrit shumë mundësinë e kërkimit të pavarur për secilin prej tyre.</p> <p><i>Annex 1.1 Statute</i> <i>Annex 1.6 Strategic Plan</i> <i>Annex 2.3 Master Thesis Guidelines</i> <i>Annex 1.25 Research Strategy</i> <i>Annex 3.16 Research Assessment Policy for Faculty of Economics and Business</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Në legjislacioni e brendshëm deklarohet se çdo vit çdo njësi duhet të bëjë një buxhet të brendshëm të miratuar nga Dekani, e më pas nga Senati. Ky buxhet, sipas legjislacionit të brendshëm, ndahet për kërkime shkencore, pjesëmarrje në konferenca, bursa për vizita dhe aktivitete të tjera. Në fund të vitit, raporti i vlerësimit individual duhet të tregojë zbatimin konkret të këtyre aktiviteteve si dhe përfimet prej tyre.</p> <p>Ekziston një procedurë që përpiqet të planifikojë buxhetin e vitit akademik që po hyn. Kështu, cdo departament dhe anëtarët e tyre akademikë në fillim të vitit akademik propozojnë një buxhet për veprimtaritë e ardhshme shkencore kërkimore gjatë vitit. Buxheti miratohet nga Senati dhe Bordi i Administrimit. Buxheti ndahet për promovimin e stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca dhe metoda</p>

	<p>të tjera botimi. Mënyrat e tjera të ngritjes në detyrë, veçanërisht kur gradimi përbëhet nga një gradë më e lartë akademike, kompensimi pasqyrohet në të drejtat mujore të shpërblimit.</p> <p><i>Annex 1.1_Statute</i> <i>Annex 1.3_Budget template</i> <i>Annex 1.3.1_Departmental Meeting SS for budget proposal</i> <i>Annex 1.19_Academic Promotion Guidelines</i></p>								
Konkluzione	<p><i>Ekziston një procedurë vjetore që bëhet në fillim të cdo viti akademik në lidhje me parashikimet e buxheteve për të mbështetur financiarisht njësitë bazë dhe ato kryesore për mbarevajtjen dhe rritjen e kërkimit shkencor cilesor të stafëve ku zhvillohet program master i shkencave. Studentët, përmes këtij programi, ndihmohen të zhvillojnë aftësitë dhe interesin kërkimor dhe udhëhiqen në përzgjedhjen e temave kërkimore në përputhje me interesin e tyre profesional dhe studimor.</i></p> <p><i>Çdo kurs ka në përbërje një komponent praktik, i cili fokusohet në projekte dhe kërkim shkencor. Studentët udhëzohen të zbatojnë metodat e kërkimit shkencor dhe të mbledhin të dhëna nga terreni, përveç rishikimit të literaturës që do të kryejnë. Në kuadër të këtyre studimeve kërkimore në shkallë të vogël, ata punojnë individualisht dhe i paraqesin rezultatet në klasë për të marrë komentet e kolegëve dhe profesorëve. Studentëve u jepet liria për të punuar në tema që janë me interes të madh për ta dhe/ose kanë të bëjnë me profesionin e tyre.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>UNYT një nga shtyllat e veprimtarisë së tij ia ka dedikuar punës kërkimore shkencore. Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Inovacionit, ka në fokus organizimin dhe bashkëpunimin e njësive të angazhuara në veprimtaritë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuar, inovacionin dhe projektet në fusha të ndryshme si drejtësia, qeverisja, shoqëria, ekonomia, tregtia, industria, teknologjia, informatika, energjetika etj.</p> <p>I organizuar që në nivel rektorati e në njësi bazë dhe kryesore, e përcjellë edhe në misionin dhe vizionin e vet, dhe e reflektuar në të gjitha dokumentat strategjike, mbështetja me infrastrukturë kërkimore është e rëndësishme për UNYT.</p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe	<p>Sugjerohet në të ardhmen që njësia bazë të përfshihet në një projekt konkret për të testuar programet që ofron departamenti (bachelor administrim biznesi dhe master i shkencave administrim biznesi me 6 profile) me të gjitha permirësimet që do të përfshihen në vitin e ardhshëm akademik 2023 2024 dhe që fillojnë në muajin dhjetor 2023 për këtë program studimi. UNYT duhet të vijojë të jetë pararojë në tregun</p>



studentët për realizimin e këtyre objektivave.	kombëtar të arsimit të lartë dhe për këtë ka nevojë të jetë proaktiv, pra të paraprijë ndryshimet e mundëshme që kërkon tregu dhe t'i reflektojë ato sa më parë duke u bërë model për IAL e tjera.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Kërkimi është një nga karakteristikat e tij përcaktuese përmes një agjende më të fokusuar në kërkimin shkencor për pesë vitet e ardhshme dhe në të ardhmen afatgjatë. Nëpërmjet kësaj qasjeje, UNYT është angazhuar të theksojë rëndësinë dhe vlerën e kërkimit në nivel institucional dhe të rrisë bashkëpunimin e tij kërkimor brenda dhe jashtë vendit. Stafi akademik po angazhohet gjithnjë e më shumë në kërkimin shkencor duke botuar rregullisht në revista të vlerësuara nga kolegët dhe duke prezantuar në konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare. Temat e hulumtuara janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit. <i>Annex 2.19_Research Pillars 2019-2022</i> <i>Annex 2.20_Research Pillars 2023-2027</i> <i>Annex 3.16_Research Assessment Policy for Faculty of Economics and Business</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	UNYT është një institucion i Edukimit të Lartë që promovon një klimë aktive kërkimore, e cila shtrihet në të gjitha programet e studimit. Për të adresuar nevojat e integritit të rezultateve të kërkimit dhe kërkimit në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit, grupet kërkimore të krijuara në të gjithë universitetin, përfshirë Departamentin e Administrimit të Biznesit, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe shtyllave kërkimore të universitetit. Rrjedhimisht karakteri kërkimor shkencor ofron një qasje të mirë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Mundësitë e mësimin në fundjavë, mësimi në anglisht, kurrikula që kanë origjinë nga MBA cilësore dhe lider në treg, përbëjnë disa tregues të shëndetshëm për sigurimin e faktit se të diplomuarit janë profesionistë konkurrues.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional	NA


<i>Qualifications Directive, 2005/36/EU).</i>							
Konkluzione	<p><i>Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit aktualisht është i angazhuar në tre shtylla të mëdha kërkimore, përkatësisht "Menaxhimi i Projekteve dhe Stili i Liderimit, Zhvillimi Ekonomik dhe Financiar, dhe Biznesi Ndërkombëtar, Turizmi dhe Ekonomia e Dijes".</i></p> <p><i>Është më se e kuptueshme se studentët me punimin e tyre të tezave të diplomës teza janë lojtarë aktivë në projektet kërkimore të lartpërmendura në UNYT së bashku me profesorët përkatës.</i></p> <p><i>Programi MScBA është një program masteri shkencor dhe i orientuar në punë kërkimore, që përfshin një gamë të gjerë kursesh dhe disiplinash. Kërkimi është një nga karakteristikat e tij përcaktuese përmes një agjende më të fokusuar në kërkimin shkencor për pesë vitet e ardhshme dhe në të ardhmen afatgjatë. Nëpërmjet kësaj qasjeje, UNYT është angazhuar të theksojë rëndësinë dhe vlerën e kërkimit në nivel institucional dhe të rrisë bashkëpunimin e tij kërkimor brenda dhe jashtë vendit</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënimit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Bazuar në Nenin 65 të Rregullores së NYU – mësimdhënia realizohet nëpërmjet leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve të laboratorit, detyrave, praktikave profesionale, detyrave të kursit etj. Gjithashtu, në Nenin 17 të Rregullores së Fakultetit, pika a. – Kurrikula përcakton lëndët, laboratorin, praktikat, projektin e diplomimit, seminarët, etj.</p> <p>Vihet re që <i>ka nevojë për një konvergencë të lehtë të termave që përdoren në përputhje me legjislacionin shqiptar, për këtë arsye sugjerojmë që njësitë e cilësisë të unifikojë termat e përdorur në secilën nga rregulloret.</i></p> <p>Silabusët e programit të studimit Master i Shkencave "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë japin disa informacione mbi temat e</p>

	<p>leksioneve, metodologjinë e të nxënit kryesisht përmes leksioneve, seminareve, konsultimeve, punës në grup dhe punës individuale, në përputhje me një format të miratuar në Senatin e Universitetit.</p> <p><i>Evidentohet që silabuset nuk janë në përputhje të plotë me VKM 41 dt 24/01/2018, veçanërisht në përshkrimin e temave të leksionit, të literaturës për çdo temë dhe të metodologjisë, faqeve të referimit.</i></p> <p><i>Silabuset nuk ruajnë plotësisht të njëjtin format nga lënda në lëndë në dhënien e temave Në silabus duhet të paraqiten dhe javët/temat në të cilat keni të ftuar në auditor të cilat duhen parashikuar që në fillim të semestrit.</i></p> <p><i>Mënyra e organizimit të masterit, me module, një lëndë e përqëndruar në 2 jave, 4 ditë me 10 orë në ditë, vlerësojmë se ka vend për diskutim për shkak se mësimdhënia, mësimxënia ka vështirësitë e veta dhe realizimi i të gjitha objektivave që lënda ka duket pak e vështirë.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullorja e Universitetit</i> <i>Dokumenti 1.8: Rregullore e Fakultetit</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimxënies.</p>	<p>Gjatë takimit në universitetin me pedagogët që japin mësim në program dhe me studentët, një element që ata e konsideronin të rëndësishëm është lidhja e teorisë me praktikën dhe tregun e punës, përmes të ftuarve në auditor, vizitave në kompani/organizata dhe qasjes së pedagogëve për t'i dhënë një karakter aplikativ mësimdhënies së tyre dhe në përputhje me Strategjinë e Mësimdhënies dhe Mësimxënies së UNYT.</p> <p>Pedagogët janë ndërveprues me studentët dhe kjo reflektohet dhe me faktin që në silabusin e çdo lëndë jepen gjithashtu dhe oraret e konsultimeve, por mungon përcaktimi konkret i metodave alternative sipas temave, pra linqet e videove, case study etj që përdoren gjatë zhvillimit të lëndës, ndonëse në Planin Strategjik janë të qartësuar.</p> <p><i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 6.18: Strategjinë e Mësimdhënies dhe Mësimxënies</i> <i>Dokumenti 1.6: Plani Strategjik 2020-2025</i> <i>Dokumenti 3: RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UNYT konsideron mbështetjen ndaj stafit akademik si një nga prioritetet kryesore të tij. Nën këtë filozofi të shprehur përmes Strategjisë e Mësimdhënies dhe Mësimxënies, Strategjisë së ndërkombëtarizimit, Marrëveshjeve Erasmus, një sërë partneritetesh të tjera jepet një kontribut i qenësishëm në përmirësimin e kompetencave akademike.</p> <p>Gjithashtu, një faktor i rëndësishëm janë dhe trajnimet në drejtim të metodologjive dhe mësimdhënies, platformave të ndryshme si dhe</p>



30



	<p>menaxhimi përmes vendosjes së objektivave individuale në fillim të vitit për çdo anëtar të stafit akademik.</p> <p>Duhet theksuar që gjatë takimit në institucion, pedagogët u shprehen dhe për mbështetjen financiare që ata marrin në botime, apo në evente (konferenca, seminare) të rëndësishme për ekspertizën e tyre.</p> <p><i>Dokumenti 6.18 ose 3.5: Strategjia e Mësimdhënies dhe Mësimnxënies</i> <i>Dokumenti 1.19: Academic Promotion Guidelines;</i> <i>Dokumenti 1.14: Strategjia e Ndërkombëtarizimit</i> <i>Dokumenti 5.2: Erasmus dhe Mevlana Mobilitete</i> <i>Dokumenti 3.9; Trajnimi EBSCO;</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik, drejtuesit dhe studentët u shprehën që numri i vogël i studentëve në klasë jep mundësinë e ndërveprimit dhe të një procesi mësimdhënie e nxënie që padyshim vë në qendër studentin.</p> <p>Rastet studimore, platformat e shumta online, biblioteka e pasuruar me libra bashkëkohore, të ftuarit në auditor, detyrat e kursit, projektet e përbashkta në grup, jo vetëm nxisin të mësuarin kritik, por nga ana tjetër përgatisin studentët për tregun e punës.</p> <p>Ashtu sic shprehen studentët dhe pedagogët, por dhe stafi mbështetës dhe zyrat e studentëve, në institucion tashmë është ndërtuar një kulturë e respektit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, që krijon përkatësi me universitetin (pedagogët e departamentit kanë një periudhë të gjatë kohë që punojnë në UNYT), por dhe studentët ndjehen të vlerësuar dhe të kënaqur me sistemin.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>UNYT ka ngritur sistemin e brendshëm të menaxhimit të cilësisë, e cila në thelbin e vet synon përmirësimin e vijueshëm të procesit mësimor dhe të gjithë veprimtarisë ë universitetit (përmes dy njësise Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë) ku departamenti ka një rol proaktiv.</p> <p>Instrumentat e përdorur për menaxhimin e cilësisë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësorët e vlerësimit simestral të studentëve, nga i cili prodhohet Raporti i Vlerësimit të Pedagogut nga studentët 2. Vlerësimi përmes kolegëve me eksperiencë të kolegëve të rinj 3. Raporti i transparencës së vlerësimit <p>Raportet e mësipërme janë elementë të diskutimit të drejtuesit të departamentit me pedagogun dhe natyrisht, problematikat reflektohen tek Raporti Vjetor i Departamentit, duke shërbyer për përmirësimin e procesit në UNYT.</p> <p>Gjithashtu, studentët janë të përfshirë përmes pjesëmarrjes së tyre në Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, Senat, këshillat e fakulteteve si dhe rolit të Unionit Studentor.</p>

	<p><i>Dokumenti 1.6: Plani Strategjik</i> <i>Dokumenti 1.7: Rregullore e UNYTT</i> <i>Dokumenti 6.1: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 6.3: Rregullore e Brendshme e KoGaSC</i> <i>Dokumenti 6.7: Rregullore e Zyrës së Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 6.18: Strategjinë e Mësimdhënies dhe Mësimnxënies</i> <i>Dokumenti 1.13: Raporti Vjetor i Departamentit</i> <i>Dokumenti 6.9: Formular i Vlerësimit të Studentëve</i> <i>Dokumenti 6.4: Formulari i vlerësimit të kolegëve</i> <i>Dokumenti 6.9.1 – 6.9.5.: Raport I Vlerësimit të Studentëve</i> <i>Dokumenti 6.10: Formulari i Performancës Personale</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, UNYT ka ngritur dy njësi që sigurojnë monitorimin dhe menaxhimin e procesit të cilësisë akademike: Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Zyrën e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, anëtarët e këtyre dy njësive u shprehën që në vite aktiviteti i tyre ka ardhur duke u përmirësuar dhe rritur peshën e ndikimit në vendimarrjet akademike të universitetit. Tashmë këto dy njësi ka hartuar dhe miratuar rregulloret dhe manualin e punës së tyre, Gjithashtu, është krijuar një rutinë pozitive institucionale në lidhje me vlerësimin e pedagogëve dhe formulimin e raportit të vlerësimit të studentëve; vlerësimin e performancës individuale të pedagogëve; raportin e transparencës së notave, raportin vjetor të departamentit.</p> <p><i>GJV sugjeroi që si metodë alternative mund të përdoren dhe fokus grupet me studentët, nga i cili mund të merren informacione të vlefshme dhe për përmirësimin e proceseve administrative, marketingut të universitetit etj.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e UNYTT</i> <i>Dokumenti 6.1: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 6.3: Rregullore e Brendshme e KoGaSC</i> <i>Dokumenti 6.7: Rregullore e Zyrës së Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 1.13: Raporti Vjetor i Departamentit</i> <i>Dokumenti 6.9: Formular i Vlerësimit të Studentëve</i> <i>Dokumenti 6.9.1 – 6.9.5.: Raport i Vlerësimit të Studentëve</i> <i>Dokumenti 6.10: Formulari i Performancës Personale</i> <i>Dokumenti 6.21: Modeli i Raportit të Transparencës së Notave</i> <i>Dokumenti 6.4: Formulari i vlerësimit të kolegëve</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se UNYT më bën përpjekje të qenësishme për të garantuar procesin e të nxënësve, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, dhe ka ndërtuar proceset e duhura në këtë drejtim. I vetmi sugjerim është plotësimi tek silabuset</i></p>


	<i>i përmbajtes së temave/javëve së bashku me format e ndryshme që realisht përdoren, në përputhje me VKM41</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregullorja e UNYT, Fakultetit dhe Departamentit përcaktojnë që vlerësimi bëhet sipas skemës: 40% provimi përfundimtar, 30% provimi ndërmjetëm 20% detyra e kursit 10% pjesëmarrja aktive.</p> <p><i>Referuar silabuseve, ka një hapësirë vlerësimi e cila lihet në funksion të autonomisë akademike e tiptologjisë së lëndës, e cila sugjerojmë që duhet parë dhe reflektuar dhe nga Rregulloret institucionale.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e UNYT</i> <i>Dokumenti 1.8: Rregullore e Fakultetit</i> <i>Dokumenti 1.9: Rregullore e Departamentit</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion pedagogët dhe studentët u shprehën që në orën e parë të mësimin, pedagogu qartëson të gjithë elementët e silabusit, që nga përmbajtja dhe literatura, kodin e etikës, mënyrën e testimit të dijeve, mënyrën e zhvillimit të detyrave dhe projekteve.</p> <p>Brenda çdo lëndë dhe në përputhje me specifikat e tyre, pedagogu gëzon lirinë akademike në organizimin e orës së leksionit&orës së seminarit, përdorimit të formave të ndryshme case study, video, punë në grup, study visit, etj si dhe në formën specifike të kontrollit të njohurive dhe formulimit të testeve.</p> <p>E gjithë kjo veprimtari bëhet në përputhje me Rregulloren e Fakultetit, Departamentit dhe Programit të Studimit dhe në përputhje me Manualin e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><i>Dokumenti 1.8: Rregullore e Fakultetit</i></p>


	<p><i>Dokumenti 1.9: Rregullore e Departamentit</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 6.1: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Lëndët e programit të studimit MSH "Administrim Biznesi" me 6 profile krijojnë mundësinë e përdorimit të disa metodave të vlerësimit; nga testet në provimin ndërmjetëm dhe përfundimtar në detyrat e kursit, case study, punën në grup, pjesëmarrjes aktive në orët e seminarit, prezantimeve të të rasteve, simulimit, study visit, praktika mësimore dhe punimit të tezës së diplomës, duke demonstruar në këtë mënyrë dhe aftësinë për kërkim dhe shkrim akademik.</p> <p>Çdo pedagog në përputhje me tipologjinë e lëndës që zhvillon dhe eksperiencën e lirinë e tij akademike, ndërton testet, ndërton kërkesat për detyrat e kursit dhe projektet.</p> <p><i>Në silabus, duhet të specifikohen temat dhe metodologjia që përdoret në çdo temë, të vendosen rastet studimore me literaturën dhe linqet përkatës si dhe të qartësohen në rregulloret institucionale forma e vlerësimit.</i></p> <p><i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në përputhje me Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren e KoGaSC dhe Rregulloren e Zyrës së Sigurimit të Cilësisë, përdoren këto forma formale të vlerësimit të cilësisë në mësimdhënies</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Formulari i Vlerësimit të Studentëve (bëhet në mënyrë periodike në çdo semester, para provimeve semestrale) 2. Vlerësim i kolegëve nga kolegët (bëhet zakonisht për kolegët e rinj nga kolegët me më shumë përvojë) 3. Raporti i Transparencës së Notave <p>Gjithashtu, për shkak të numrit të kufizuar të studentëve, ndërveprimi me ta është i vazhdueshëm dhe kjo krijon mundësinë e reagimit ndaj kërkesave të tyre.</p> <p><i>Sugjerim i GVJ ishte që mund të përdorin dhe fokus grupet për të kuptuar më shumë dhe reflektuar dhe ndaj aspekteve të tjera të administrimit të universitetit dhe zyrave mbështetëse.</i></p> <p><i>Dokumenti 6.1: Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 6.4: Formulari i Vlerësimit të Kolegëve</i> <i>Dokumenti 6.3: Rregullore e Brendshme e KoGaSC</i> <i>Dokumenti 6.7: Rregullore e Njësive të Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Dokumenti 6.9: Formulari i Vlerësimit të Studentëve</i></p>




	<i>Dokumenti 6.9.1: Vlerësimet e pedagogëve nga studentët</i>		
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion pedagogët u shprehën për metodat e ndryshme që ata përdorin gjatë zhvillimit të lëndës së tyre dhe synimin e tyre për të lidhur teorinë me tregun si dhe aftësuar studentët e dhënë njohuri në përputhje me nevojat e bizneseve/organizatave në Shqipëri e më gjërë.</p> <p>Gjithashtu, studentët konfirmuan që mësimdhënia bëhet më interesante kur krahas leksionit dhe seminareve, trajtimit të rasteve studimore dhe detyrave të kursit, ata kanë mundësi të takojnë drejtues biznesi/administratorë e siëprmarës, të bëjnë vizita studimore në biznese dhe të ndërveprojnë me situata reale të tregut.</p> <p><i>Vlen të theksojmë në RVJ rekomandimin që ofruam për stafin dhe drejtuesit e njësisë kryesore/bazë, paraqitjen në silabus të lëndës të çdo forme mësimdhënie të përdorur në leksion dhe seminar, të linqeve, të rasteve studimore, të artikujve të ndryshëm dhe të kapitujve të librave të përdorur, të të ftuarve në auditor – temën që ata do të trajtojnë, etj duke plotësuar në këtë mënyrë dhe kriterin ligjor të VKM 41.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 2.6: Vizita në Agna Group</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 2.12.1: Sample lesson plan agenda Week 2</i> <i>Dokumenti 2.7: Guest speaker</i> <i>Dokumenti 6.18: Strategjia e Mësimdhënies dhe Mësimnxënies</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ mendon që në lidhje me standardin “Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre”, UNYT bën përpjekje që krahas rregulloreve të respektojë dhe lirinë akademike të pedagogut, tipologjinë që lënda ka si dhe të maksimizojë raportet me tregun e punës në funksion të mësimnxënies së studenteve.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit, dhe Silabusin e lëndës përcaktohet mënyra e vlerësimit të njohurive, aftësive të përfituara e cila bazohet në rregulloret e institucionit (UNYT dhe Fakultetit) si dhe padyshim në VKM 41të vitit 2018.</p> <p>Në Programin Master i Shkencave "Administrim Biznesi" me profile: " a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë , kryesisht vlerësimi varet nga lënda, por dhe mënyra e të konceptuarit de të zhvilluarit të saj më module, detyrë kursi dhe pjesëmarrje aktive në seminare, diskutim i rasteve studimore, etj.</p> <p>Pedagogu i lëndës qartëson në orën e parë të mësimit mënyrën e kontrollit të dijës, në dy javët, 40 orët që zhvillohet mësimi.</p> <p>UNYT përdor sistemin e vlerësimit amerikan A, B etj të cilat rezultojnë nga vlerësimi me sistemin e pikëve nga 0 në 100 për çdo element të vlerësimit të studentit.</p> <p>Mënyrën dhe sistemin e vlerësimit të studentëve e shqyrtuam dhe në regjistrat themeltarë të institucionit gjatë vizitës.</p> <p><i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 2.12.1 dhe 2: Sample lesson plan agenda Week 1 and 2</i> <i>Dokumenti 2.16: Skedulimi i kursit sipas vitit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> <p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Numri i studentëve në grupet e Masterit të Shkencave në Administrim Biznes me profile është i vogël dhe studentët mund të menaxhohen më së miri, ndërkohë UNYT ka mundësinë e përdorimit të Turnitin për detyrat dhe tezat e diplomave, McGraw Hill dhe gjatë kohës së pandemisë ka përdorur testimin elektronik.</p> <p>Transparenca në vlerësim vlerësohet përmes Raportit të Transparencës së Notave, i cili është një nga dokumentat e vlerësimit të cilësisë së procesit dhe në funksion të shmangieve diskutohet nga drejtuesi departamentit me pedagogët.</p> <p>Rëndësia e transparencës dhe e origjinalitetit merret përsipër nga studentët që në momentin e regjistrimit dhe plotësimit të dokumentacionit, ku krahas dokumentacionit bazuar në ligj, firmoset dhe një dokument etik, evidentuar gjatë vizitës në institucion dhe komunikimit me personat përgjegjës të sekretarisë mësimore.</p> <p>Gjithashtu, në silabusin e lëndës një rubrikë i dedikohet kodit të etikës, është detyrë e pedagogut ta sjellë në vëmendje në orën e parë të mësimit</p>

	<p>bashkë me elementë të tjerë si dhe në funksion të output-it të studentit gjatë zhvillimit të lëndës ta risjellë në vëmendje.</p> <p><i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 2.12: Raporti i transparencës së Notave</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 2.12.1 dhe 2: Sample lesson plan agenda Week 1 and 2</i> <i>Dokumenti 2.16: Skedulimi i kursit sipas vitit</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion studentët u shprehën që pedagogët gjatë orës së parë qartësojnë mënyrën e vlerësimit të tyre, u japin informacion dhe i mbështesin për të kuptuar si duhet të qasen në raport me lëndën, mënyrën e testimit, angazhimin në klasë apo zhvillimin e detyrave. Ndërkohë dhënia e rezultateve të testimit bëhet 7 ditë pas zhvillimit të provimit, komunikohet përmes sekretarisë dhe sistemit Egnonom, ku studentët kanë akses të plotë në marrjen e informacionit, nga ambientet e shkollës, por dhe jashtë saj</p> <p>Në se student nuk dakordësohet me vlerësimin e pedagogut, atëherë ai i drejtohet Zyrës së Çështjeve Mësimore brenda 48 orëve nga dalja e rezultateve dhe plotëson Peticionin Akademik dhe përmes një procedure testimi rishikohet, në rast se nuk ndryshon vlerësimi student ka të drejtë të kërkojë ngritjen e një komisioni. GVB ka qartësuar përmes dokumentacionit dhe një praktikë ndryshimi të vlerësimit. Siç kemi theksuar dhe më lart, Transparenca dhe Paanshmërie në vlerësim e pedagogut është objekt i punës së Zyrës së Cilësisë dhe të Raportit të Transparencës në Vlerësim.</p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore universitetit</i> <i>Dokumenti 1.8: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 5.29: Peticioni akademik</i> <i>Dokumenti 2.12: Raporti i transparencës së Notave</i> <i>Dokumenti 3.2: Student's honor code</i> <i>Dokumenti: 4.7: Kodi etikës</i> <i>Dokumenti 3.8: Sample of exam script ëith comments</i> <i>Dokumenti 3.10.2: aksesi I notave të studentit me GNOMON</i> <i>Dokumenti 3.8.1: Sample of thesis evaluation form complete</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me standardin "Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit" vlerëson se UNYT ka plotësuar më së miri çdo kriter të këtij standardi dhe ka krijuar një kulturë institucionale për t'u përgëzuar.</i></p>





37



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë, ky program studimi synon të aftësojë studentët-profesionistë për të punuar në tregun lokal dhe ndërkombëtar.</p> <p>Programi synon që krahas njohurive në fushën e administrimit të biznesit, të thellojë të menduarit kritik dhe të analizës së situatës, të aftësojë për të menaxhuar situata të ndryshme të biznesit, si dhe t'i përfshijë në diskutime të thelluara teorike dhe aplikative.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion synuam të kuptonim logjikën mbi bazën e të cilit është formuluar programi dhe oferta akademike e Departamentit të Administrim Biznesit, përmes diskutimit me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë.</p> <p>UNYT vjen nga një praktikë e suksesshme prej shumë vitesh të këtij programi studimi, studentët që e ndjekin vijnë nga një formim bachelor ekonomik, por dhe nga fushave të tjera si juridik apo IT, për këtë arsye këta të fundit duhet të ndjekin 3 lëndë formuese pa kredite.</p> <p>Vlerësuesit konsiderojnë që programi për mënyrën si është hartuar merr në konsideratë dhe garantimin e efikasitetit të kostos së programit, në kushtet e një universiteti që punon me një segment të ngushtë të tregut të arsimit të lartë dhe me një profil të caktuar studentit.</p> <p><i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 1.6. Plani strategjik i UNYT</i> <i>Dokumenti 1.25: Strategjia e studimit të tregut</i> <i>Dokumenti 1.24: Studimi i tregut</i> <i>Dokumentii 2.1.: Tabelat përmbledhëse (tab 9 dhe tab 10)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë. përbëhet kryesisht nga kjo ndarje lëndësh:</p>

<p>ndërveprimi (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A: LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme: 6 ECTS – 5 % (Kriteri - 5% -10%) - Kategoria B: LËNDË KARAKTERIZUESE –përgatitje për disiplinën shkencore: 72 ECTS – 60% (Kriteri 50% -60%); - Kategoria C: LËNDËT NDERDISIPLINORE/ INTEGRUESE nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje: 12 ECTS – 10% (Kriteri 12%- 20%) - Kategoria D: LËNDË PLOTËSUESE: gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale: 12 ECTS – 10% (Kriteri 10%) - Kategoria E: DETYRIME PËRMBYLLESE: 18 ECTS -15% (Kriteri 10%-15%) <p><i>GVJ evidenton që praktikisht, kategoria C, D dhe E – pra 42 kredite shkojnë në thelb për punimin, përgatitjen dhe mbrotjen e diplomës. Mendojmë e gjykojmë që ky raport duhet përmirësuar, në funksion të lëndëve të kategorisë A dhe C.</i></p> <p>Nëse do t'i referohemi Tab.9 të Tabelave përmbledhëse vihet re që profilizimi vjen jo përmes lëndëve me zgjedhje, por nëpërmjet ndërhyrjeve të vogla nga një profil në tjetrin në lëndët karakterizuese, ndërkohë <i>studentët në konceptin tonë duhet të kishin mundësi zgjedhjeve.</i></p> <p>Duhet thënë që programi i studimit MSH "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d.Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë. ka në përbërje lëndët tradicionale që një program i tillë ka më të gjitha shkollat e biznesit, lëndë të formimit të karakterit social si dhe 1 lëndë që lidhen me sistemet e informacionit</p> <p>Gjatë diskutimit me pedagogët, ata u shprehën për <i>nevojën për një sërë ndërhyrjesh pozitive dhe inovative në përmbajtje të programit që priten të bëhen në vitin e ardhshëm akademik (por sigurisht u duhej të përmbyllnin procesin e akreditimit).</i></p> <p><i>Dokumentii 2.1.: Tabelat përmbledhëse (tab 9 dhe tab 10)</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullorja e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në VM 41/2018, në Rregulloren e Programit të Studimit, Silabusi (formati i të cilit është miratuar në Senatin e UNYT) përmban objektivat e të nxënësve, metodologjitë e të nxënësve, mënyrën e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit.</p> <p>Gjithshka që lidhet me njohuritë, aftësitë dhe përjasjen që lënda krijon, mënyrën e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit u qartësohet studentëve në orën e parë të zhvillimit të lëndës. Gjithshka bazohet në Rregulloren e Programit të Studimit, veçoritë që lëndët kanë si dhe në respekt të lirisë akademike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, Drejtuesja e Departamentit na qartësoi për mënyrën se si departamenti bën analizat vjetore dhe semestrale në lidhje</p>





	<p>më këtë kriter. Vend të rëndësishëm zë dhe reflektimi mbi Raportin e Transparencës së Vlerësimit, i cili hartohet në mënyrë periodike për një pjesë të lëndëve.</p> <p><i>Dokumenti 2.2: Silabuset</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullorja e programit</i> <i>Dokumenti 3.2: Formati i objektivave vjetore të departamentit</i> <i>Dokumenti 2.12.1 dhe 2: Sample lesson plan agenda Week 1 and 2</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit</p> <p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ diskutoi me stafin akademik të këtij për diversitetin e metodave të mësimdhënies të përdorura në lëndët e programit të studimit Master i Shkencave "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë.</p> <p>Nga të ftuarit në auditor, vizita në biznese, punë në grup, seminare dhe evente me tematikë specifike, projekte janë disa nga format e cituara nga stafi dhe të evidentuara përmes dokumentacionit <i>Sample lesson plan agenda week 1 and 2</i></p> <p>Megjithate, vlen të theksojmë që: <i>Së pari, metodologjitë e përdorura duhen specifikuar në çdo temë e lëndë</i> <i>Së dyti, të ftuarit, vizitat dhe evente të tjera duhen vendosur në silabus.</i></p> <p>Universiteti dhe departamenti, bëjnë përpjekje për t'i mbajtur studentët e informuar për të gjitha veprimtaritë formuese, inovuese dhe shkencore, sic dëshmojnë thirrjet në faqen e universitetit dhe komunikimet e bëra,</p> <p>Fakulteti dhe departamenti bëjnë përpjekje për të mbështetur veprimtaritë shkencore të pedagogëve, bazuar në dokumentin e shtyllave të veprimtarisë shkencore. Gjithashtu, pedagogët u shprehën që në përputhje me kërkesat që ata paraqesin drejtuesit mbështesin me fonde kërkimin dhe aktivitetet e tyre. <i>Sugjerohet më shumë përfshirje e studentëve dhe më shumë proaktitet në ndërkombëtarizim dhe projekte</i></p> <p><i>Dokumenti 1.10: Rregullorja e programit</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset</i> <i>Dokumenti 2.12.1 dhe 2: Sample lesson plan agenda Week 1 and 2</i> <i>Dokumenti 2.4: Komunikime për thirrjen e studentëve në "Induction day"</i> <i>Dokumenti 2.6 – Vizitë në Agna Group</i> <i>Dokumenti 2.7: Lista e të ftuarve</i> <i>Dokumenti 2.8: aktivitetet</i> <i>Dokumenti 2.19: research pillars 2019-2022</i></p>


	<p><i>Dokumenti 2.20: research pillars 2023-2027</i> <i>Dokumenti 3.16: Reseach assessment policy</i> <i>Dokumenti 4.31: Budget plan</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson që në UNYT dhe departamenti i Administrim Biznesit janë plotësisht të përkushtuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, sugjerojmë që Departamenti duhet të rishikojë raportin e krediteve në përputhje me VKM 41/2018, futjen të disa lëndëve më innovative, më shumë përfshirje të studentëve në punët shkencore dhe projektet.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Shkencave "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë., me rregullore është përcaktuar që detyrimi përmbyllës është vetëm punim diplome,</p> <p>Bazuar në dokumentat e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, - Rregulloren e UNYT; - Rregulloren e Fakultetit, përkatësisht nenet 16 dhe 17; - Rregulloren e Programit të Studimit, përkatësisht nenet 26, 29 dhe 30 - Rregulloren e Projektit të Diplomimit <p>janë përcaktuar kushtet që duhen plotësuar për të nisur punimin e diplomës.</p> <p>Gjithashtu, rregulloret përcaktojnë dhe procedurat që ndiqen për projektin e diplomës. Projekti i Diplomës bën pjesë në detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) dhe përmban 18 ECTS -15% (Kriteri 10-15%), por në fakt diploma është 42 ECTS.</p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullorja UNYT</i> <i>Dokumenti 1.8: Rregullorja e fakultetit</i> <i>Dokumenti 1.9: Rregullorja e departamentit</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullorja e programit</i> <i>Dokumenti 2.3: Rregullorja e projektit të diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, pedagogët e departamentit u shprehën që gjatë realizimit të punimit të diplomës, studentëve u caktohet një</p>

<p>dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblylëse.</p> <p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblylës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>këshillues dhe dy suportues. Bazuar në Silabusin e projektit të diplomimit ata mbështesin studentin në procesin e shkrimit të diplomës.</p> <p>Për mënyrën si është konceptuar punimi i tezës së diplomës, studentët fillimisht ndjekin lëndën “Hyrje në projektin e tezës”, e cila i drejton në elementët kryesorë të shkrimit të punimit. Në lidhje me realizimin e kërkimit primar, udhëheqësi suporton në gjetjen e organizatës/biznesit dhe orët e zhvilluar për mbledhjen e informacionit primar e sekondar konsiderohen si Praktikë, Studentët punojnë më pas në mënyrë individuale, duke u këshilluar e ndërvepruar me pedagogun udhëheqës. Faza e fundit është Mbrotja e Tezës - 6 ECTS.</p> <p>Rëndësi të veçantë në institucion i jepet përdorimit të programit të plagjaturës, dhe dorezimi i raportit të tij është detyrim për studentin</p> <p><i>Dokumenti 1.9: Rregullorja e departamentit</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullorja e programit</i> <i>Dokumenti 3.4: Udhëzimet për shkrimin e temës së diplomimit</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset</i> <i>Dokumenti 2.28: Call for master thesis defence</i> <i>Dokumenti 3.6: Snapshot communication on graduate conference</i> <i>Dokumenti 3.6.3: Snapshot communication on thesis committee and turnitin report</i> <i>Dokumenti 3.8.2: Sample of turnitin similarity report master thesis</i> <i>Dokumenti 3.12: Projektimi ngarkesës</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për natyrën e programit të studimit Master i Shkencave “Administrim Biznesi” me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë, Universiteti dhe departamenti mbështet studentët, në përdorimin e ambienteve të bibliotekës, bibliotekave digjitale, laboratorit të IT dhe programit SPSS për përpunimin e të dhënave.</p> <p>Në funksion të temës, pedagogët e departamentit janë të gatshëm të asistojnë studentët për çdo nevojë që ato kanë për realizimin me sukses të punimit, brenda kriterëve ligjore dhe të rregulloreve të institucionit.</p>



	<p>Duhet theksuar që numri i vogël i studentëve, mundëson një suport të mirë të studentëve, gjë që u theksua prej tyre. Gjithashtu, për mbledhjen e të dhënave primare shërben praktika mësimore.</p> <p><i>Dokumenti 2.3 Rregullorja e projektit të diplomimit</i> <i>Dokumenti 3.7: Sample thesis committee per student</i> <i>Dokumenti 4.1.2: Emerald insight service contract</i> <i>Dokumenti 4.9: Politikat dhe procedurat e bibliotekës</i> <i>Dokumenti 4.17: Shërbimet e suportit informatiko – teknologjik</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, si dhe në Rregulloren e Projektit të Diplomimit bëhet vlerësimi i studentëve në diplomë nga komisioni i përkohshëm i ngritur për vlerësimin e punimeve. Sistemi i vlerësimit i përdorur në punimin e diplomës është sistemi i UNYT (sistemi amerikan).</p> <p><i>Dokumenti 1.9: Rregullorja e departamentit</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullorja e programit</i> <i>Dokumenti 2.3: Rregullorja e projektit të diplomimit</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset</i> <i>Dokumenti 3.6: Snapshot communication on graduate conference</i> <i>Dokumenti 3.6.3: Snapshot communication on thesis committee and turnitin report</i> <i>Dokumenti 2.18.1: thesis evaluation form</i> <i>Dokumenti 3.8.1: Sample of thesis evaluation form</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master i Shkencave “Administrim Biznesi” me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë. në fund të studimeve, pasi kanë fituar 120 ECTS dhe një mesatare 50/100, bazuar në Rregulloren e Programit, pajisen me diplomë, në të cilën krahas emërtimit të MSH në Administrim Biznes, vendoset dhe profili. Kjo zgjidhje që bëhet nën frymën e ligjit, është në përputhje të plotë dhe me qasjen e UNYT për të ofruar një ofertë të pasur akademike në kushtet e një universiteti të vogël.</p> <p>Në përputhje me Rregulloren e UNYT, si dhe të rregulloreve të MAS, në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës. Institucioni në funksion të kërkesës së studentëve mund të ofrojë dhe kopjen e programit të studimit me silabuset, bazuar në një procedura të caktuar.</p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullorja UNYT</i></p>



	<p><i>Dokumenti 1.10: Rregullorja e programit</i> <i>Dokumenti 6.7: Rregullorja e Zyrës së Cilësisë</i> <i>Dokumenti 3.10.3: Sample of student official transcript</i> <i>Dokumenti 3.11.1: Sample of degree program check</i> <i>Dokumenti 3.14: Sample of Msc diploma</i> <i>Dokumenti 3.14 nga 1-6: Suplementi i diplomës, sipas profileve</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në ligj, Rregulloren e UNYT për sekretarinë mësimore dhe Rregulloren e Arkivës, janë një sërë dokumentash të cilët duhen mbajtur, dhe ruajtur në dy faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatë zhvillimit të studimeve, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim; - pas përfundimit të studimeve, ku dosja e studentit kalon me dokumentat kryesorë në Arkivën e Universitetit. <p>Gjatë vizitës së GVJ të jashtëm në institucion, u kërkuan për verifikim disa dosje personale studentësh nga Sekretaria Mësimore, nga ku u evidentua që gjithshka ishte konform ligjit..</p> <p><i>Dokumenti 5.4: Rregullorja e Sekretarisë</i> <i>Dokumenti 5.5: Rregullorja për Arkivën</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës, UNYT plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe ka ngritur të gjithë sistemin e procedurave dhe rregulloreve e dokumentacionit, për këtë qëllim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>



<p>Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>N/A</p>

Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N/A			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N/A			
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për	Gjatë takimit në institucion me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, një nga çështjet e diskutuara kishte të bëntë me stafin akademik. Departamenti i Administrim – Biznesit plotëson kriterin ligjor (Neni 25, pika 4 të ligjit Nr. 80/2015) duke patur në përbërje 7 pedagogë, nga të cilët 1 Prof. Dr., 2 anëtarë janë PhD, 2 anëtarë janë Dr. dhe dy të tjerë doktorandë.


<p>nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nëse shikojmë dhe listën e pedagogëve të jashtëm që mbulojnë lëndë të departamentit evidentojmë që ka një kombinim të pedagogëve të huaj me ata shqiptarë, për të cilët duhet thënë që një pjesë janë personalitete të fushave të caktuara të biznesit në tregun shqiptar.</p> <p>Gjatë bisedës me stafin e brendshëm të departamentit, u evidentua që ata kanë krijuar grupet e lëndëve (ndonëse në skemën formale të organizimit të departamentit nuk ekziston një nën-njësi e tillë) në të cilët angazhohen në mësimdhënie, dhe kjo krijon mundësinë e specializimit të tyre dhe thellimit dhe në punën shkencore e projekte.</p> <p><i>Dokumentii 2.1.: Tabelat përmbledhëse (tab 1 dhe 2 – sipas viteve përkatëse)</i> <i>Dokumentii 2.1.1: CV e personelit akademik</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Duke u referuar në tabelat përmbledhëse - Tab.1 per vitin 2022-2023 evidentuam një problematikë në raportin PAE/PAK. Gjatë takimit në institucion kërkuam një sqarim nga drejtuesja e departamentit, e cila përmes tabelave shitesë për çdo profil, paraqiti stafin e brendshëm dhe të jashtëm, referuar numrit të krediteve të lëndëve që mbulojnë, kështu rezultoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitet 2020-2022 PAE/PAK 85/15 (%) - Për vitin 2022-2023 PAE/PAK 75/25 (%) <p>Ngarkesa e departamentit menaxhohet nga drejtuesi i departamentit, i cili në ndarjen e ngarkesës mbështetet në ekspertizë. Ndonëse aktet nënligjore lejojnë që një pedagog mund të zhvillojë deri në 6 lëndë, në departamentin e Administrim –Biznesit në maksimum pedagogët kanë 5 lëndë dhe si lëndë e gjashtë është drejtimi i studentëve në diplomë</p> <p>Bazuar në projektimin e ngarkesës për vitin 2022-2023, vihet re që ngarkesa e tyre vjetore është përgjithësisht e balancuar, në ngarkesë përfshihet dhe drejtimi i punimeve të diplomës dhe gjithshka është konceptuar dhe zbatuar në përputhje me aneks kontratën.</p> <p><i>Dokumentii 2.1.: Tabelat përmbledhëse (tab 1 dhe 2 – sipas viteve përkatëse)</i> <i>Dokumentii 2.1: Tabela 10 - Ngarkesa në mësimdhënie</i> <i>Dokumentii 4.27.: Anekset e kontratave</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë</p>	<p>Në vlerësimin e GVJ, një nga pikat e forta të Departamentit të Administrim Biznesit është qëndrueshmëria e pedagogëve, disa prej tyre kishin kaluar mbi një dekadë në UNYT, duke ruajtur përkatësinë, valorizuar eksperiencën dhe duke krijuar një frymë pozitive në raportet institucionale dhe me studentët.</p>

<p>periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Vlen gjithashtu të theksohet, që dhe stafi i jashtëm kishte në një raport të qëndrueshëm me departamentin, një pjesë e pedagogëve të jashtëm ruajnë raportin e bashkëpunimit me universitetin që nga dita e parë e krijimit të tij dhe sipas rastit departamenti dhe universiteti kanë gjetur modalitetin e bashkëpunimit me ta.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion vlerësuam dhe dosjet e personelit të brendshëm dhe të jashtëm, që përmbanin të gjithë dokumentacionin e duhur sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë kontratën dhe aneks-kontratën.</p> <p><i>Dokumentii 4.28; 4.28.1' 4.28.2.: Kontrata e punës sipas kategorive Dokumentii 4.27.: Aneks kontrata e punës</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin 80/2015 mbi Arsimin e Lartë , Kodin e Punës si dhe akte të tjera nënligjore, në Statutin e UNYT, përkatësisht në Nenin 41 dhe 42, përcaktohen politikat e rekrutimit.</p> <p>Mësimdhënia në gjuhën angleze, vendos si kriter mjaft të rëndësishëm zotërimin ekselent të gjuhës duke i dhënë prioritet individëve që kanë studjuar apo zhvilluar ciklin doktorat në IAL ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë u shprehën se ndeshin vështirësi në gjetjen dhe rekrutimin e personelit akademik në kategorinë profesor, për shkak të barrierës që krijohet nga zotërimi i gjuhës angleze në nivel akademik.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i silabuseve vihet re që i njëjti pedagog jep disa lëndë brenda programit MSH, marrë në konsideratë dhe mënyrën si zhvillohet lënda me module, mendojmë që ka vend për përmirësim, MSH në mësimdhënie kërkon më shumë thellim dhe ekspertizë, nga ana tjetër studentët kanë nevojë të shohin dhe këndvështrime të ndryshme në auditor.</i></p> <p>Thirrjet për punësim janë publike, ato publikohen në faqen e UNYT, komisioni i rekrutimit për shkak të madhësisë të universitetit, ka zakonisht në përbërje Rektorin, Dekanin, Drejtuesin e Departamentit, një staf akademik dhe një përfaqësues nga BNJ. Procesi i selektimit merr në konsideratë specifikimet e punës të bëra publike dhe mbi bazën e tyre bën renditjen e kandidatëve.</p> <p><i>Dokumenti 1.1: Statuti Dokumenti 2.2.: Silabuset Dokumentii 4.25: Formati i shpalljes së pozicionit Dokumentii 4.25.1: Formati standard i procedurës së rekrutimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e</p>	<p>Për natyrën e programit të studimit Master i Shkencave "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i</p>

<p>personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë institucionit siguron dhe garanton përmes bashkëveprimit të departamentit, sekretarisë mësimore, departamentit të operacioneve dhe personelit të IT zbatimin e programit dhe vënien në funksion të të gjithë ambjenteve të domosdoshëm përfshirë laboratorët në të cilët zhvillohen lëndët e IT.</p> <p>Prioritet të veçantë zënë elementët e sigurisë së individit dhe të ambientit, fakt që evidentohet mjaft qartë nga tërësia e dokumentave të paraqitur në portal.</p> <p><i>Dokumentii 4.3: Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse: Politika dhe procedura</i> <i>Dokumentii 4.5: Çertifikatë për r mbrojtjen nga zjarri</i> <i>Dokumentii 4.6 nga 1 në 10: Çertifikata, trajnime dhe vlerësime risku</i> <i>Dokumentii 4.14: Manuali i politikave të sigurisë</i> <i>Dokumentii 4.17: IT Shërbimet</i> <i>Dokumentii 4.16: IT data protection policy</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore, u informuam që tërësia e dokumentacionit që ata mbledhin dhe zotërojnë është në përputhje të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Punës. Gjithashtu, në bashkëpunim me një studio të jashtme ligjore kanë mundur të definojnë gjithë punën e tyre, në mënyrë që të mbrojnë dhe stafin dhe institucionin nga çdo shmangie që mund të shkaktojë problematika.</p> <p>Përsa i përket raportit PAE/PAK, për programin e studimit Master i Shkencave "Administrim Biznesi" me profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë, pasqyra është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitet 2020-2022 PAE/PAK 85/15 (%) - Për vitin 2022-2023 PAE/PAK 75/25 (%) <p>Në Aneksin e Tabelave Përmbledhëse, në Tab. 4; dhe 4.1 gjejmë informacionin mbi ngarkesat mësimore për pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të Departamentit të Administrim Biznesit për periudhën kohore në të cilën programi akreditohet.</p> <p>Dosjet e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm ishin të plota, me CV të standartizuara dhe të përditësuara. Në faqen e UNYT në internet gjenden gjithashtu dhe jetëshkrimet e stafit https://unyt.edu.al/index.php/faculty/</p> <p><i>Dokumentii 2.1.: Tabelat përmbledhëse (tab 4)</i> <i>Dokumentii 2.1.1.: CV e personelit akademik</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> <p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Duhet theksuar që UNYT ka një sistem të mbështetjes së studentit të kapilarizuar, që në momentin e regjistrimit ku i përcaktohet pedagogu këshillues, i cili e suporton gjatë gjithë periudhës së studimeve, diplomën e praktikën përfshirë .</p> <p>Gjithashtu, në suport të studentit janë Zyra e Çështjeve Studentore, Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Zyra e Karrierës e cila specifikisht mbështet për praktikën, intershipet, organizimin e Panairit të Punës dhe punësimin e studentëve.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, kuptuam që praktika e studenteve të masterit inkorporohet me punën kërkimore që bëhet për tezën e diplomës së masterit. Kështu, studentët, në bazë të temave dhe pyetjeve kërkimore të përzgjedhura, zgjedhin kompaninë/kompanitë ku zhvillojnë takime intensive kualitative si dhe zhvillojnë anketa për mbledhjen e të dhënave nga menaxheret, punonjësit apo klientët. Kështu, praktikën janë zhvilluar në kompani të tilla si Agna Group, Mrizi i Zanave, Union Bank, Bank of Albania, Bashkia e Tiranës, One Telecommunications, Hotelëritë në Durrës, Bashkia e Vlorës, University of Neë York Tirana, Balfin Group, Hako, CFO Farma etj.</p> <p>Vlerësimi është pjesë integrale e vlerësimit që bëhet për tezën e masterit në total, duke marrë në konsideratë dhe punën e kryer gjatë praktikës.</p> <p><i>Dokumenti 5.11: Rregullore Zyra e Karrierës</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard, UNYT duhet të bëjë të mundur një diversitet më të madh të pedagogëve që angazhohen në mësimdhënie, nisur nga pikëpamja e kualifikimi dhe ekspertizës në fusha specifike, përpos vështirësive që në mënyrë të natyrshme vijnë nga mësimdhënia në gjuhën angleze. Qëndrueshmëria e stafit të Departamentit të Administrimit Biznesit është një pikë e fortë e këtij programi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UNYT aktualisht zhvillon aktivitetin e tij në dy godina, programi i studimit NSH "Administrim Biznesi" me 6 profile zhvillohet pranë godinës në Kodrën e Diellit në Tiranë .</p> <p>Duket që drejtuesit e universitetit në planet e tyre kanë vendosur që të jenë konkurrues në tregun e arsimit të lartë përmes investimeve të reja (Fakulteti IT, filloi aktivitetin kë të vit në godinën e re shumë bashkë kohore), kështu për vitin 2023-2024 programet e studimit të Fakultetit Ekonomik do të zhvendosen në një godinë pranë zonës së 21 Dhjetorit, duke rritur në këtë mënyrë aksesueshmërinë dhe përmirësuar hapësirën e ndërveprimit.</p> <p>Godina në të cilën zhvillojnë procesin mësimor aktualisht ka të gjitha ambjentet për zhvillimin e procesit mësimor, zyrat administrative, laboratorë IT, bibliotekën, ambiente rekreative dhe Zyrat e suportit të studentit të vendosura në katin hyrës të godinës.</p> <p>Godina është e siguruar ndaj risqeve dhe kjo konfirmohet përmes një tërësie dokumentash.</p> <p><i>Dokumenti 4.4. Akti i miratimit të Main Bulding</i> <i>Dokumentii 4.5: Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri</i> <i>Dokumentii 4.6 nga 1 në 10: Çertifikata, trajnime dhe vlerësime risku</i> <i>Dokumentii 4.14: Manuali i politikave të sigurisë</i> <i>Dokumenti 4.10: Kontratë Qiraje</i> <i>Dokumenti 4.12: Sipërfaqet në funksion të mësimdhënies</i> <i>Dokumenti 4.13: Ambjenti i bibliotekës</i> <i>Dokumenti 4.8: Raporti i Analizës së ujit</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Godina e UNYT ku zhvillohet mësimi në programin e studimit MSH në Administrim Biznes me 6 profile plotëson kushtet për zhvillimin normal të mësimdhënies në kushtet e numrit të vogël të studentëve.</p> <p>Mjediset për zhvillimin e mësimin, laboratorët e IT, biblioteka dhe mjediset e tjera që suportojnë studentët t nga pikë pamja administrative dhe zhvilluese, janë konceptuar nga pikëpamja infrastrukturore dhe logjistike, për një zhvillim sa më normal të procesit mësimor dhe jetës në universitet.</p> <p>E gjithë godina mbulohet me internet dhe ambjentet janë të pajisura me pajisjet e duhura.</p> <p><i>Në takimin me studentët, ata u shprehën se do të kishin preferuar që të ishin të gjithë studentët e UNYT në të njëjtin kampus, si dhe për vështirësitë e parkingut (por tashmë kjo ë shtë një problematikë në të gjithë Tiranën, universitetet publike dhe private përfshirë).</i></p> <p><i>Dokumentii 4.14: Manuali i politikave të sigurisë</i></p>

	<p><i>Dokumentii 4.17: IT Shërbimet</i> <i>Dokumentii 4.16: IT data protection policy</i></p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në administrim biznes përmbush objektivat e tij në mësimdhënie për lëndët e natyrës IT, nëpërmjet laboratorit të informatikës.</p> <p>Gjithashtu, një ambjent atraktiv është biblioteka e cila krahas librave fizikë , ka një hapësirë me PC për përdorimin e bibliotekave online dhe zhvillimin e hulumtimeve.</p> <p>Në funksion të procesit mësimor janë një sërë programesh dhe aplikacionesh, të cilayt mbështesin studentët si McGraë Hill, Turnitim SPSS, etj.</p> <p><i>Dokumenti 4.4. Akti i miratimit të Main Bulding</i> <i>Dokumenti 4.12: Sipë rfaqet në funksion të mësimdhënies</i> <i>Dokumenti 4.13: Ambjenti i bibliotekës</i> <i>Dokumenti 4.17. IT shërbimet</i> <i>Dokumenti 4.12: Sipërfaqja në funksion të mësimdhë nies</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>N/A</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard UNYT po synon të lëvizë strategjikisht në lidhje me mjediset mësimore dhe infrastrukturën. Në vitin e ardhshëm akademik parashikohet që Fakulteti Ekonomisë dhe Biznesit të zhvendoset në një godinë në qendër të Tiranës, me një aksesueshmëri të lartë dhe që krijon mundësi për rritje dhe më shumë jetë studentore</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Në se do t'i referoheshim silabuseve të lëndëve të programit të studimit MSH në AB, qartë evidentohet që literatura është në anglisht, kryesisht e përdorur nga shkollat më të mira ndërkombëtare, e përditësuar dhe kryesisht e 5 viteve të fundit.</p> <p>Literatura që i vihet në shërbim studentëve, ajo e detyrueshme dhe e rekomanduar sigurohet përmes librave në bibliotekën fizike të UNYT, por dhe përmes librave online të cilat mund të aksesohen nga studentët nga ambjentet e bibliotekës së UNYT.</p> <p>Në traditën e UNYT, çdo vit një fond i caktuar i buxhetit të universitetit shkon për përditësimin e literaturës. Gjatë vizitës në bibliotekë, punonjësja e saj, evidentoi dhe librat e rinj të blerë këtë vit akademik për programin e BA dhe të cilat ishin reflektuar dhe në silabuse.</p> <p>Biblioteka funksionon përmes një politike të qartë, e cila u mundëson studentëve dhe pedagogëve të aksesojnë dhe përdorin literaturën e duhur, në një mjedis që ndodhet në katin e 2 nëntokësor të godinës, ku pjesa e fondit fizik me atë të hapësirës së kompjuterave janë në harmoni me njëra tjetrën dhe krijojë një hapësirë të përshtshme për të punuar</p> <p>Buxheti i bibliotekës shkon 15 deri në 20 mijë euro/vit.</p> <p><i>Dokumenti 2.2: Silabuset</i> <i>Dokumenti 4.31: Buxheti</i> <i>Dokumenti 4. 9: Politika dhe procedura të bibliotekës</i> <i>Dokumenti 4.13: Ambjentet e bibliotekës</i> <i>Dokumenti 4.1: Raporti i blerjes së librave 2020-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë</p>	



<p>ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UNYT, prej vitesh ofron literaturën bazë, të rekomanduar dhe tekste të tjera e udhëzues në përputhje me qasjen akademike dhe shkencore të institucionit dhe në përgjigje të zhvilimeve të reja në kurrikul dhe në treg. 8100 tituj akademikë dhe 8480 volume ofrohen nga fondi fizik, Gjithashtu, përmes librarisë online ofrohet dhe katalogu elektronik, I gjithë menaxhimi I punës së saj bëhet përmes një programi.</p> <p>Natyrisht, për shkak të diapazonit të fushave, programeve të studimit, konceptit të ndërtimit të kurrikulave, biblioteka si përmes fondit fizik ashtu dhe atij online ofron mundësi shumë të mira të formimit dhe zhvillimit.</p> <p>Biblioteka për disa nga libraritë online krijon mundësinë e aksesimit dhe nga ambjente të tjera brenda godinës së universitetit si dhe jashtë saj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, punonjësja e bibliotekës na qartësoi gjithë mënyrën e funksionimit të saj. Biblioteka është e hapur gjatë gjithë javës, fundjavën përfshirë dhe ky ishte një fakt i rëndësishëm për t'u vlerësuar. Në hyrje të bibliotekës dhe faqen e internetit të UNYT paraqiten oraret e saj</p> <p><i>Dokumenti 4. 9: Politika dhe procedura të bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>UNYT për shkak të mësimdhënies në gjuhën angleze dhe të literaturës po në gjuhën angleze, në vite ka ndërtuar një politikë dhe sistem procedurash specifike në raportet department-pedagog-bibliotekë dhe student-bibliotekë.</p> <p>Bazuar në RVB si dhe në vizitën në institucion, vlerësojmë që treguesit si numri i materialeve të kataloguara, lexues në universitet, përdorues të brendshëm dhe të jashtëm janë impresionues nisur nga numri i vogël i studentëve që UNYT ka dhe zbehjes së raportit me librin dhe leximin që Gjenerata Z ka.</p> <p><i>Dokumenti 4. 9: Politika dhe procedura të bibliotekës</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me literaturën e nevojshme silabuset janë të përditësuara në literaturën më të mirë të 5 viteve të fundit kryesisht, UNYT ka një përfaqëse shumë positive ndaj buxhetimit çdo vit të fondit të librave sipas kërkesës së departamenteve dhe një proaktivitet në menaxhimin e bibliotekës.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>UNYT administrohet të gjithë informacionin që ka lidhje me ecurinë e studentëve në vite, nga momenti i regjistrimit deri në atë të diplomimit përmea programit GNOMON.</p> <p>Ky program menaxhon informacionin në lidhje me të dhënat personale, të dhënat e ecurisë akademike, plan programet, të dhënat financiare. Njësitë administrative: Sekretaria mësimore ka akses të plotë në të gjitha modulet e programit; Zyra e Financës akseson, hedh e përpunon të dhënë në modulin e financës; departamentet në plan programet zyrtar në suport të studentëve kanë akses të kufizuar.</p> <p>Ky sistem i menaxhimit të informacionit, lehtëson punën e disa njësive, lehtëson ndërveprimin, ofron informacion për studentët në kohë reale, krijon mundësinë e regjistrimit të tyre, pra në thelb përmirëson menaxhimin e informacionit në institucion.</p> <p><i>Dokumenti 4.20: Platforma GNOMON</i> <i>Dokumenti 4.20 nga 1- 5: akses i studentëve</i> <i>Dokumenti 5.4: Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore</i> <i>Dokumenti 4.21: Akses i pedagogëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të</p>	<p>Departamenti i Burimeve Njerëzore administrohet dosjet fizike të stafit të brendshëm dhe të jashtëm, të cilat përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Një sugjerim i bërë nga GVJ gjatë vizitës në UNYT ishte që në dosjen e stafit akademik të shtohet dhe vlerësimi vjetor i performancës.</i></p> <p>Gjatë vizitës u informuam gjithashtu, që nisur nga ky vit do të fillonte vlerësimi i performancës së stafit administrativ, nëpërmjet një procedure që njësia e BNJ po e hartonte.</p> <p>Në sistemin aktual GNOMON, studentët hyjnë për të parë ecurinë e tyre në mësim dhe për të bërë regjistrimin e lëndëve, ndërsa pedagogët vetëm për të parë ecurinë e studentëve.</p>

gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Gjithashtu, në momentin që bëhesh student dhe staf I UNYT, merr nga zyra IT kredencialet e tua dhe email tënd me @unyt.edu.al <i>Dokumenti 4.19: Adresa elektronike për secilin student</i> <i>Dokumenti 4.21: Aksesi i pedagogëve</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	<i>Në UNYT, sistemi GNOMON menaxhon vetëm sistemin e të dhënave që lidhet me studentin, mungon një system Learning Management System që do të mundësonte një ndërveprim pedagog-student shumë më të mirë dhe që do përmbante dhe gjithë informacionin leksione, libra, case study, video, silabus etj, të ngarkuara nga pedagogët dhe ku studentet do të kishin kanalën e tyre të komunikimit dhe të ngarkimit të detyrave, projekteve, etj. Në kushtet e një universiteti të vogël, mungesa LMS mund të mos jetë thelbësore në ndërveprim, por sigurisht në planet e ardhshme të UNYT do të duhet të përfshihet.</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare e UNYT (https://unyt.edu.al/) jep të gjithë informacionin e duhur për përdoruesit e sistemit të UNYT (studentë dhe pedagogë) dhe për të gjithë të tretët që duan të informohen për universitetin nisur nga historiku dhe akreditimet, kurrikulat, regjistrimi i studentëve, njësitë dhe zyrat në shërbimet të studentëve, aktivitetet e shumta dhe jeta në kampus <i>Aktualisht, faqja aktuale është vetëm në anglisht, ndërkohë që është në përpunim një faqe e re shumë më interactive dhe informuese, në dy gjuhë shqip dhe anglisht.</i> Gjithashtu, një mjet i fuqishëm i informimit janë faqet në mediat sociale si facebook; Instagram, linkedin etj			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që krahas sistemit GNOMON, UNYT duhet të bëjë përpjekje dhe për ngritjen e një LMS për ta bërë më të plotë ndërveprimin pedagog-student, përmes sistemeve të menaxhimit të informacionit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për	UNYT si një institucion privat i arsimit të lartë në Shqipëri, por dhe për shkak të detyrimeve ligjore analizon:

<p>programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>- Shpenzimet dhe të ardhurat e programit të studimeve (në rastin tonë të programit AB me 4 profile;</p> <p>- Analizën e kostos së programit</p> <p>- Analizën e fitimit/humbjes.</p> <p>Mbi bazën e këtyre tre analizave, menaxhimi i universitetit në bashkëpunim me departamentin dhe njësinë e financës, marrin masat për të gjithë sistemimet, ndërhyrjet që duhen bërë për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>Dokumenti 4.33: Pasqyrat financiare 2020</i> <i>Dokumenti 4.33.1: Pasqyrat financiare 2021</i> <i>Dokumenti 4.35: Raporti kosot-efektivitet</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në</p>	<p>UNYT si një institucion privat i arsimit në varësi të Fondacionit Turk Maarif, siguron burimet e financimit përmes tre burimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tarifata vjetore të studentëve; - financim nga Fondacioni Turk MAARIF - projektet kërkimore shkencore <p>UNYT në periudhën Prill- Maj të çdo viti kalendarik nis procedurën e formulimit të buxhetit sipas skemës nga poshtë lart, pra nisur nga nevojat e departamentit për staf akademik, investime e shpenzime operationale, projektionet e studentëve sipas programeve për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>Projekt – Buxheti, si rregull kalon miratohet në Senat dhe në Bordin e Administrimit të UNYT, e shërben më pas si plan financiar për administrimin e universitetit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UNYTsi çdo subjekt tjetër privat i arsimit të lartë në Shqipëri, i nënshtrohet auditimit periodik përmes të cilit kontrollon dhe garanton që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e financë - kontabilitetit funksion në respekt të ligjeve të RSH, përmbush detyrimet ligjore dhe fiskale; - Njësia e financës kontabilizon dhe nxjerr pasqyra financiare dhe bën analizat e kostos; - Njësia e financës mat me përpikmëri eficienten e operationeve; - Njësia e financës menaxhohen siç duhet hyrje-daljet e parasë <p><i>Dokumenti 4.30: Raporti i Auditimit</i> <i>Dokumenti 4.33: Pasqyrat financiare 2020</i> <i>Dokumenti 4.33.1: Pasqyrat financiare 2021</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të</p>	<p>UNYT ka ngritur të gjithë infrastrukturën e duhur njerëzore dhe të sistemeve financiare për të menaxhuar me efektivitet dhe për të</p>

<p>studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>garantuar qëndrueshmërinë e institucionit, mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe garantimin e studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimit, si dhe garantimin në këtë mënyrë të qëndrueshmërisë së stafit akademik dhe administrativ</p> <p>Nga pasqyrat financiare evidentohet që qëndrueshmëria financiare garantohet nëpërmjet donacioneve nga Fondacioni Turk Maarif.</p> <p><i>GVJ vlerëson që nga pikëpamja strategjike Bordi i Administrimit të UNYT, duhet të përqaset në gjenerimin e burimeve të treta të financimit, dhe sugjerojmë më shumë angazhimin në projekte europiane e më gjerë.</i></p> <p><i>Dokumenti 4.31: Plan Buxheti</i> <i>Dokumenti 4.34: Procedura e buxhetimit</i> <i>Dokumenti 4.33: Pasqyrat financiare 2020</i> <i>Dokumenti 4.33.1: Pasqyrat financiare 2021</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që UNYT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, nëpërmjet dhe mbështetjes financiare të Fondacionit Maarif. Në afatgjatë duhet menduar nga Fakulteti dhe departamenti Administrim Biznesit për gjenerimin e të ardhurave përmes projekteve ndërkombëtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje,</p>	<p>UNYT ngre të gjithë veprimtarinë e tij akademike dhe administrative duke patur në qendër studentin. Politikat dhe procedurat e universitetit të bazuara në ligj dhe në filozofinë e tij, mbështesin studentin që nga momenti kur aplikanti/kandidati potencial kërkon të informohet, më pas</p>


<p>në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>kur bëhet student, kalon 3 vitet e bachelorit dhe diplomohet, e vijon si alumni.</p> <p>Në dosjen e çdo studenti të UNYT, evidentojmë që krahas dokumentave që kërkon ligji, se bashku me kontratën dhe aneks-kontratën, gjejmë të përcaktuar dhe pedagogun këshillues (pedagog nga departamenti nga i cili studenti diplomohet), i cili e mbështet, suporton gjatë gjithë periudhës së studimit.</p> <p>Për të gjitha procedurat e regjistrimit në MSH, krahas pjesës ligjore të përcaktuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, VKM për regjistrimin në U-Albania dhe udhëzime e akte të tjera nënligjore, UNYT përkujdeset që aplikanti- student të mbështetet dhe me informacion të plotë mbi programin e studimit që preferon.</p> <p>Në Statutin e UNYT – Neni 6, garantohen të drejtat dhe barazia e individëve në aplikim dhe në përgjedhje, sigurisht dhe gjatë gjithë periudhës së studimit.</p> <p>Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike alokuar në katin hyrës të godinës së univesitetit, së bashku me Zyrat e tjera administrative dhe të shërbimit ndaj studentit, luajnë një rol të rëndësishëm që çdo student të marrë shërbimin e duhur dhe të lehtësohet në sistem.</p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullorja e universitetit</i> <i>Dokumenti 5.3: Kuotat</i> <i>Dokumenti 5.17: Ditët e hapura dhe vizitat e studentëve</i> <i>Dokumenti 3.22: Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> <p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të</p>	<p>Në lidhje me kriteret e pranimit në programin bachelor në adminstrim biznes, UNYT zbaton Ligjin 80/2015. Udhëzimet e MAS dhe Vendimin e Senatit të UNYT Nr 89/2023 për dëshminë e gjuhës angleze (detyrim që vjen nga fakti që mësimi bëhet në anglisht). Dokumentat të cilat dorëzohen janë në përputhje me ligjin për Arsmin e Lartë</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve të huaj bazohen në ligj dhe udhëzimin Nr.17/2019.</p> <p>Përsa i përket transferimeve, zbatohet Ligji 80/2015 dhe udhëzimet që MAS nxjerr çdo vit akademik në prag të regjistrimeve. Transferimi bëhet i mundur përmes një procedure të caktuar, por me kushtin që 50% të krediteve të përfitohen në UNYT.</p> <p>UNYT informon të gjithë të interesuarit për kriteret e pranimit dhe regjistrimit në universitet, përmes faqes në internet, broshurave,</p>

<p>mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>reklamave, panairove të ndryshme, ditëve të hapura, kurseve të maturës, medias sociale, dhe stafit të zyrave të këshillimit të studentëve, dekanin e studentëve, etj.</p> <p>Aktualisht, UNYT ka dhënë përmes një provimi për studentët ekselentë bursa, dhe që nga viti ardhshëm do ofrojë dhe bursa sociale.</p> <p><i>Dokumenti 5.3: Kuotat</i> <i>Dokumenti 5.17: Ditët e hapura dhe vizitat e studentëve</i> <i>Dokumenti 3.22: Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike</i> <i>Dokumenti 5.21: Dokumentat për transferim</i> <i>Dokumenti 5.22: Materiale për promovim</i> <i>Dokumenti 5.23: Politikat e bursave</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në udhëzimin Nr. 17 dt. 30.07.2019, si dhe në përvojën e krijuar në vite, UNYT përcakton kuotat për studentët me aftësi ndryshe, ata që vijnë nga pakicat dhe shtresat në vështirësi.</p> <p>Por nisur nga profili universitetit, mësimdhënia në anglisht, tarifat e studimit, studentët që vijnë nga shtresat e mësipërme kanë nevojë të mbështetn. Për këtë arsye, për këtë vit akademik krahas bursave ekselente, do të akordohen dhe bursat sociale; në këtë mënyrë universiteti vendos t'i japë vetes dhe një dimesionin të përgjegjësisë sociale.</p> <p><i>Dokumenti 5.3: Kuotat për vitin 2020-2021</i> <i>Dokumenti 5.3.1: Kuotat për vitin 2021-2022</i> <i>Dokumenti 5.3.2: Kuotat për vitin 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Bazuar në udhëzimin Nr. 17 dt. 30.07.2019, në përvojën e krijuar në vite, UNYT përcakton kuotat për përzgjedhjen e studentëve të huaj. Përsa i përket kriterëve mbeten kriteret që përcakton ligji, si dhe kriterin e zotërimit të gjuhës angleze e cila vërtetohet përmes testit intuitiv apo mbrojtjes/certifikimit.</p> <p>UNYT po punon në drejtim të ndërkombëtarizimit me studentë të huaj, veçanrisht në drejtim të sjelljes së studentëve turq, por aspektet ligjore e procedurale kërkojnë kohën e përgatitjet e tyre.</p> <p><i>Dokumenti 5.3: Kuotat për vitin 2020-2021</i> <i>Dokumenti 5.3.1: Kuotat për vitin 2021-2022</i> <i>Dokumenti 5.3.2: Kuotat për vitin 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe</p>	<p>Përmes RVB dhe vizitës në institucion, evidentuam që UNYT deri tani ka dhënë vetëm bursa ekselence, për student me mesatare shumë të lartë, por dhe me arritje të tjera në nivel kombëtar e ndërkombëtar.</p>



me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Vendimi merret nga Komisioni i Bursave, bazuar në Politikën e Bursave të UNYT dhe në aplikimet e studentëve bazuar në një sërë dokumentash që dëshmojnë/vërtetojnë ekselencën e tyre.			
	Siç u informuam, që nga Tetori 2023, pra për vitin e ardhshëm akademik do të aplikohen dhe bursat me karakter social.			
	<i>Dokumenti 5.23: Politika e bursave për vitin 2020-2021</i>			
	<i>Dokumenti 5.23.1: Politika e bursave për vitin 2021-2022</i>			
	<i>Dokumenti 5.23.2: Politika e bursave për vitin 2022-2023</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard, UNYT ka ngritur e ndjekur të gjitha procedurat në përputhje me ligjin dhe udhëzimet e VKM që burojnë prej tij, në lidhje me pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Sugjerojmë veprimin më proaktiv ndaj strategjive të ndërkombëtarizmit edhe përmes studentëve të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentët e programit të studimit MSH në Administrim Biznes me profile: . I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë., informohen mbi tërësinë e rregullave dhe të procedurave të avancimit të tyre akademik në “Ditët e Hapura” që organizohen në nisje të vitit akademik (veçanërisht për studentët e vitit të parë), bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit. Natyrisht, çdo pedagog në javën e parë të zhvillimit të lëndës qartëson elementët e vlerësimit me komponentët e saj, literaturën, detyrimin e frekuentimit, etj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UNYT implementon një sistem pa provime vjeshte, duke bërë që studenti të jetë i detyruar ta ndjekë lëndën përkundrejt një tarife të caktuar në vitin e ardhshëm akademik. Në kushtet e një numri të vogël studentësh kjo mund të mos përbëjë problematikë, por në afatgjatë kur numrat mund të rriten, kjo patjetër mund të kthehet në një disavantazh përkundrejt IAL-ve të tjera, gjithashtu vlerësojmë që mungesa e vjeshtës përtej rritjes së kostot e




	<p><i>diplomimit, për studentët e vitit të dytë mund të kthehet në humbjen e një viti të plotë, ndoshta dhe vetëm prej një lëndë e cila mund të zhvillohet në semestrin e dytë të vitit pasardhës.</i></p> <p>Studentët ndjekin ecurinë e tyre akademike përmes sistemit GNOMON, i cili menaxhon të gjitha të dhënat e studentit, pedagogët e brendshëm kanë gjithashtu akses për të shikuar ecurinë e studentëve, por pa patur të drejtë të hedhin të dhëna në të.</p> <p>Gjithashtu, çdo student ka këshilluesin e tij akademik i cili e shoqëron në tre vitet e studimit, që e suporton në paqartësitë që mund të ketë dhe që së bashku me Zyrën për Çështjet e Studentit, fasilitojnë përparimin e tij në sistem.</p> <p><i>Dokumenti 5.17: Ditët e hapura</i> <i>Aneksi 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 2.2: Silabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 4.21: Aksesit studentit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Zyra për Çështjet Studentore ofron informacion për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të transferojnë studimet nga një universitet tjetër, qoftë ky brenda apo jashtë Shqipërisë.</p> <p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë, udhëzimet e MAS për transferimet (të përditësuara vit pas viti dhe bazuar në Rregullat e Maturës Shtetërore) si dhe në rregulloret e brendshme të UNYT, studentët ndjekin një procedurë aplikimi, informimi dhe më pas ngrihet një komision i përkohshëm që vlerëson programet, silabuset dhe që propozon kreditet dhe lëndët që duhen marrë, nisur gjithmonë nga kriteri që 50% e krediteve duhet të merren në UNYT. Bazuar në këtë vlerësim të komisionit të përkohshëm Dekani i Fakultetit aprovon dhe Rektorati miraton kreditet që njihen.</p> <p><i>Dokumenti 5.21: Dokument për transferim</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 5.24: Komunikim me studentët ndërkombëtar</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Programi Administrim - Biznes bachelor me 4 profile ka si detyrim përmbyllës, punimin e diplomës, realizimi i të cilit merr në konsideratë kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar dhe që burojnë nga rregulloret bazë të UNYT dhe më specifikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullores së Universitetit (Nenet: 28, 29) - Rregullores së Fakultetit (Nenet: 16, 17) - Rregullores së Departamentit të Administrim Biznesit (Nenet: 15-18); - Rregullores së Programit të Studimit (Nenet: 26, 29 dhe 30)

	<p>Mbi këtë bazë është konceptuar Rregullorja e Projektit të Diplomimit, e cila i qartësohet studentëve nga pedagogu udhëheqës.</p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e UNYT</i> <i>Dokumenti 1.8: Rregullore e fakultetit</i> <i>Dokumenti 1.9: Rregullore e departamentit</i> <i>Dokumenti 1.10: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Dokumenti 3.4: Rregullore e projektit të diplomimit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UNYT ndjek disa rrugë për informimin e kandidatëve për studentë për vitin e ardhshëm akademik, të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra për Çështjet Studentore është gjatë gjithë vitit në funksion të informimit të çdo personi të interesuar për të studjuar në UNYT apo familjari të tij; - Zyra për Çështjet Studentore përgatit një plan vjetor aktiviteteve të cilat i zbaton në bashkëpunim me zyrat e tjera në suport të studentit, Zyrës së Marketingut dhe PR, dhe departamentit të administrimit biznesit; - Ditët e Hapura të zhvilluara në institucion; - pjesëmarrja në panairt e organizuara nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në qytetet kryesore të Shqipërisë; - botimet e fletëpalojeve, broshurave, spotëve në TV dhe publikimet në faqen e UNYT dhe në median sociale; - organizimin e kurseve të maturës për maturantët (kryesisht online) <p><i>Dokumenti 5.17: Ditët e hapura</i> <i>Dokumenti 5.22: Materiale për promovim</i> <i>Dokumenti 5.23; 5.23.1; 5.23.2.: Politika e bursave sipas viteve</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me këtë standard vlerëson se UNYT mban të informuar studentët për përparimin akademik, diplomimin e tyre dhe nga pikëpamja procedurale dhe aksesit ka ngritur sistemin e duhur në funksion të informimit të studentëve..</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për</p>	



<p>strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese</p> <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>UNYT ka ngritur sistemin e plotë për informimin e studentëve dhe të interesuarve për studentë dhe të familjarëve të tyre për programet e studimit, organizimin dhe rregullat bazë të funksionimit, si dhe të gjithë mundësinë që institucioni krijon për karrierën e tyre.</p> <p>Studentët aktualë dhe të ardhshëm informohen përmes disa mundësive:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqja zyrtare e UNYT në internet (https://unyt.edu.al/) - Zyrës për Çështjet Studentore - Materialeve promovuese broshura, fletëpalosje, etj - Ditëve të hapura – ku roli i Departamentit në qartësimin e strukturës së programit është shumë i rëndësishëm, por dhe zyrat administrative, përfshirë Sekretarinë Mësimore luajnë një rol rëndësishëm në plotësimin e të gjithë elementëve që student ka interes. Gjithashtu, qartësohen dhe të gjitha zyrat e tjera të cilat janë në shërbim të studentit, financa, IT, karriera, etj - Këshilluesit akademik – shoqëron dhe suporton studentin gjatë gjithë periudhës së studimit, për çështje të natyrave të ndryshme që e shoqërojnë. - Javën e parë të mësimit nga çdo pedagog, i cili qartëson të gjithë elementët e silabusit; - GNOMON, platformës së menaxhimit të të dhënave për ecurinë akademike, të cilën studenti mund ta aksesojë dhe jashtë kampusit. - Email zyrtar të studentit në UNYT, me të cilin pajiset në momentin e regjistrimit dhe të nëshkrimit të kontratës; <p><i>Dokumenti 5.17: Ditët e hapura</i> <i>Dokumenti 5.33: Plani vjetor i Zyrës për Çështjet Studentore</i> <i>Dokumenti 5.11: Rregullore e Zyrës së Karrierës</i> <i>Dokumenti 5.22: Materiale për promovim</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës në UNYT funksionon prej vitesh, duke patur një rol në mbështetjet e studentëve në karrierën e tyre, në lidhjen e universitetit me tregun e punës dhe në veçanti me bizneset, korporatat, përfshirë dhe korporatat ndërkombëtare.</p> <p>Një nga drejtimet e Zyrës janë të ftuarit në auditor, ndërkohë që eventit më i rëndësishëm i organizuar nga Zyra është Panairi i Punës apo Karrierës.</p> <p>Duhet theksuar që universiteti ka bërë përpjekje për ta organizuar këtë panair dhe në kushtet e pandemisë, duke e organizuar online në vitin 2020.</p> <p><i>Tradita shumë pozitive e funksionimit të Zyrës së Karrierës në UNYT duhet përditësuar me zhvillimet në tregun e punës, specifikat e Gjeneratës Z dhe sfidat që ndesh sot arsimit i lartë në Shqipëri, por dhe më gjerë,</i></p>

	<p><i>Dokumenti 5.11: Rregullore e Zyrës së Karrierës</i> <i>Dokumenti 5.12: Aktivitetet e Zyrës së Karrierës</i> <i>Dokumenti 5.12.1: Elona Garo Trajnim për panairin e punës</i> <i>Dokumenti 5.13: Career center ëorkshop</i> <i>Dokumenti 5.14: Agjenda për Panairin e Karrierës</i> <i>Dokumenti 5.14.1: Panairi i Karrierës online</i> <i>Dokumenti 5.14.2: ftesa për kompanitë Panairi i Karrierës;</i> <i>Dokumenti 5.14.1: Panairi i Karrierës online</i> <i>Dokumenti 5.14.3: Keynote speaker</i> <i>Dokumenti 5.14.4: Kompani të ftuara në Panairi i Karrierës</i> <i>Dokumenti 5.16: Plani i punës i Zyrës së Karrierës</i> <i>Dokumenti 5.32: Dokumenti i performances</i></p>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në UNYT ekziston sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentit (akademike dhe financiare), por mungon Learning Management system.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që aktualisht UNYT ofron informacion të plotë mbi strukturën, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit, ndërkohë që sfidat lokale dhe globale shtrojnë nevojën për rrugë e instrumenta të reja, në përputhje me gjeneratën Z dhe sfidat që tregu i punës po kalon.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UNYT mban dhe përpunon një sërë statistikash që lidhen nga njëra anë me detyrimin ligjor, nga ana tjetër janë të rëndësishme për menaxhimin e të gjithë veprimtarisë së universitetit, ndërtimit të strategjive të ardhshme, ndërhyrjet korrigjuese në sistem dhe vlerësimin e performancës së programeve, departamenteve dhe zyrave.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga	Dokumenti i Performancës që përpilohet për çdo vit nga Zyra e Karrierës dhe Sekretaria Mësimore jep një pasqyrë të performancës së studentëve, sipas programeve dhe punësimit të studentëve – e rëndësishme për të ndjekur më pas studentët si alumni.

programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Programi Master i Shkencave në Administrim Biznes me 6 profile riakreditohet, në tabelën më poshtë jepet një statistikë e numrit të studentëve, të regjistruar së bashku me ata të transferuar sipas viteve.

Viti akademik	Të regjistruar	Mesatarja	Të transferuar	Totali studentëve
2019-2020	25	8.14	1	26
2020-2021	19	8.43	1	20
2021-2022	15	7.9		15
2022-2023	11	8.14		11

Në tabelë evidentohet që mesatarja e studentëve të regjistruar në programin Ms AB me profil, përgjithësisht është 8 e lart, dhe që është ruajtur vit pas viti.

Departamenti AB ka kërkuar dhe miratuar ndryshime në MAS për vitin e ardhshëm akademik për programin MSH në Administrim Biznes me 6 profile por në masën deri 20% Sugjerojmë që pas akreditimit departamenti do të duhet të gjykojë suksesin ose jo të profileve, numrat e studentëve janë një tregues, gjithashtu të mendohet për përjasje të re rekrutimi, ndërkombëtarizimi përmes studentëve të huaj apo lëndë e përjasje që lidhen me sipërmarrjen, dixhitalizimin dhe informatikën ekonomike.

Dokumenti 2.1: Tabelat përmbledhëse (Tabelat 21)

Dokumenti 5.32: Dokumenti i performances

Dokumenti 1.22: Propozime për ndryshimin e kurrikulës MBA 2023-2024

Dokumenti 1.23: Konfirmimi për ndryshimin e kurrikulës MBA 2023-2024

Dokumenti 2.15; 1 dhe 2: Raporti vjetor i monitorimit të departamentit

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Sistemi i brendshëm i menaxhimit të të dhënave të studentëve, GNOMON funksionon me akses vetën në marrjen e informacionit të studentëve, pedagogëve të brendshëm, dhe zyra në shërbim të studentëve, ndërkohë sekretaria mësimore dhe zyra e financës hedhin të dhënat, verifikojnë dhe ruajnë të dhënat. Elementët e sigurisë përcaktojnë dhe aksesin e punonjësve të sekretarisë dhe financës në sistemin GNOMON.

	<i>Dokumenti 4.20: Platforma GNOMON</i>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Garantimi i cilësisë së menaxhimit të sistemit të administrimit të të dhënave, është konsideruar nga drejtimi i lartë si një nga elementët e procesit të auditimit. Për këtë arsye, në shkurt të vitit 2023 Rektorati ka ngritur komisionin ad hoc për auditimin e brendshëm për periudhën 2020-2022 që lidhet me akreditimin e këtij programi. <i>Në RVB dhe në platformën e Ascal nuk gjendet një raport i këtij komisioni, por besojmë se do të përpilohet në fund të vitit akademik.</i> <i>Dokumenti 6.20: Vendim Rektorati për Auditim të Brendshëm</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard UNYT mbledh, përpunon të dhënat dhe ndërton raporte të cilat i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të menaxhimit të universitetit, nevojitet të ndërtojë dhe raportet e auditimit të zyrave që punojnë në këtë aspekt.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr.80/2015, në aktet nënligjore, si dhe në Statutin dhe në disa rregullore institucionale studentët përfshihen në një sërë organesh me karakter vendimarrës, këshillues dhe procedural si më poshtë paraqitet: <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik - Këshilli Etikës; - Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë - Grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë Gjatë takimit në institucion me studentët, vlerësuam se raportet e tyre me UNYT, Departamentin dhe Zyrat janë frutdhënëse. Duket që numri i vogël i studentëve e bën më të lehtë dhe efikas komunikimin dhe bashkëpunimin mes tyre, si dhe më të thjeshtë angazhimin e studentëve. <i>Dokumenti 1.1: Statuti – Neni 67</i> <i>Dokumenti 1.9: Rregullore e Departamentit të BA – Neni 41</i>

lehtësisht të verifikueshme e të matshme.									
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<p>Studentët përfshihen në mënyrë direkte dhe indirekte në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor dhe programit të studimit. Kështu, ata bëjnë vlerësimin periodik të mësimdhënies së pedagogëve, ndërveprojnë gjatë gjithë periudhës së studimeve me drejtuesit e departamentit dhe fakultetit, ndërveprojnë dhe orientojnë pakënaqësitë apo sugjerimet e tyre në Zyrën për Çështjet Studentore, ndërveprojnë me pedagogun këshillues dhe natyrisht sjellin zërin e tyre përmes Unionit Studentor.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion GVJ sugjeroi që të përdoren dhe fokus grupet me studentët, si një mjet tjetër alternative.</i></p> <p><i>Dokumenti 6.9: Formular vlerësimi për pedagogët</i></p> <p><i>Dokumenti 6.9 nga 1-3: Raportet e vlerësimit të pedagogëve sipas viteve;</i></p>								
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Studentët kanë të drejtë të kërkojnë shpjegim për mënyrën e vlerësimit të dijeve në të gjitha format e kontrollit të dijes, nga pedagogu i tyre. Në rastin kur shpjegimi i pedagogut nuk është shterues për arsyet që studenti mbron, ai gëzon të drejtën e ankimimit nëpërmjet peticionit akademik që paraqitet tek Zyra për Çështjet Studentore.</p> <p>Më pas peticioni kalon në departament ku bazuar në një procedurë drejtuesi i tij, ngre një komision ad -hoc vlerësimi, i cili detyrimisht në fund të këtij procesi duhet të marrë një vendim rishikimi apo refuzimi.</p> <p><i>Aneksi 1.10: Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 5.31: Rregullore e brendshme e Zyrës për Çështjet Studentore</i></p> <p><i>Dokumenti 6.13: Procedura për peticionin akademik</i></p> <p><i>Dokumenti 5.29: Peticioni akademik</i></p> <p><i>Dokumenti 5.29.1: Vendim i Peticioni (administrativ)</i></p>								
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me këtë standard, UNYT respekton aspektet ligjore dhe të rregulloreve që burojnë mbi këtë bazë për përfshirjen e studentëve në një sërë organesh vendimore dhe këshilluese. Gjithashtu, nën moton studentit në qendër dhe cilësia në funksion të tij, kanë ndërtuar mekanizmat e duhura për përmirësimin e procesit mësimor dhe programit të studimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit</p>	<p>Në Rregulloren e Zyrës për Çështjet Studentore (SAO), sanksionohen të gjitha veprimtaritë e kryera prej saj, në respekt të Ligjit të Arsimit të Lartë, dhe rregulloreve të brendshme të universitetit.</p> <p>Zyra për Çështjet Studentore (SAO), shërben si hallka e parë e komunikimit të një të interesuari për programet e studimit në UNYT, duke dhënë të gjitha informacionet që nga programet, tarifat e studimit, jeta studentore, rregullat e brendshme, kalimi nga një vit në një tjetër, etj. Për studentët e nivelit të bachelorit, kjo Zyrë krahas funksioneve të cituara më lart, fasiliton gjithë ndërveprimin e studentëve me pjesën akademike dhe administrative të universitetit duke suportuar studentin gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p>Një element që GVJ evidentoi gjatë vizitës në institucion dhe komunikimit me studentët dhe stafin e kësaj Zyre, ishte që në rast të ankesave për vlerësimin e marrë në provime, apo vlerësime të tjera, studentët i drejtoheshin kësaj Zyre, dhe po përmes saj formulonte peticionin e ankesës.</p> <p>Në UNYT Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Zyra e Karrierës, Dekani i Studentit, Zyra e Marketingut dhe PR shërbejnë për të mbajtur të informuar studentin për të gjithë proceset, aktivitetet, oportunitet që atyre u shfaqen gjatë studimit të MSHt në rogramin AB në UNYT.</p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e universitetit</i> <i>Dokumenti 5.31: Rregullore e brendshme e Zyrës për Çështjet Studentore</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në historinë e universiteteve shqiptare, UNYT është universiteti i parë që ka ngritur Zyrën e Karrierës dhe që në vite krijoi një referencë shumë pozitive për tregun e arsimit të lartë në Shqipëri.</p> <p>Zyra e Karrierës ka si qëllim kryesor të ndërlihdë studentët me tregun e punës, të krijojë mundësi për të dy palët për intershipe dhe punësime, të kontribuojë në ngritjen e marrëdhënieve me tregun e punës, mbështetjen për të ftuarit në auditor, organizimin e panairit të punës.</p> <p>Zyra e Karrierës harton një plan vjetor veprimtarish të cilat i koordinon me departamentet dhe Zyrën e Marketingut dhe PR. Zyra e Karrierës bashkvepron gjithashtu me departamentet dhe njësinë e sigurimit të cilësisë në drejtim të përmirësimit të procesit mësimor, nisur nga informacioni i dhënë nga punëdhënësit,</p>

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p><i>Gjatë vizitës në institucion, bisedës me përfaqësuesit e zyrave që punojnë me studentët dhe studentët, evidentuam disa elementë që mendojmë se duhen patur në konsideratë nga UNYT:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Duhet të punohet për një përkatësi dhe krenari të studentit me emrin e UNYT dhe kjo kërkon një angazhim më të madh të zyrave që punojnë me studentët në këtë drejtim, kërkohet dinamikë në konceptim dhe realizim; - Panairi i Punës, është një event që kërkon feedback, nga studentët, nga bizneset, output të qartë, përndryshe është vetëm një event PR; - Më shumë proaktivitet në lidhje me rrjetin alumni - Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare duhet të punojnë për më shumë mobilitete të studentëve të këtij programi studimi dhe për një listë që pasurohet vazhdimisht me universitete të reja; - Zyra e Projekteve dhe departamenti më proaktivë në projekte lokale dhe ndërkombëtare, për rrjedhojë dhe në përfshirjen e studentëve në to. <p><i>Dokumenti 1.1: Statuti universitetit (neni 55)</i> <i>Dokumenti 5.11: Rregullore e Zyrës së Karrierës</i> <i>Dokumenti 5.16: Plani Vjetor i Zyrës së Karrierës</i> <i>Dokumenti 5.17: Ditët e Hapura</i> <i>Dokumenti 5.18: Feedback nga kompanitë për punësimin e studentëve</i> <i>Dokumenti 5.19: Mundësi punësimi të studentëve</i> <i>Dokumenti 5.32: Dokument i performancës</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që nga pikëpamja procedurale elementët ekzistojnë, por nga pikëpamja strategjike dhe e përmbajtjes duhet një qasje me aktive, më vizionare dhe më në forcim të brandit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe</p>	<p>UNYT ka përgjegjësinë që t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve akademike, hulumtuese dhe shërbimesh; të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e ofruara dhe të sigurojë që janë plotësuar standardet e</p>

<p>inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>cilësisë. Për të arritur sigurimin e cilësisë, UNYT ka zhvilluar një politikë të sigurimit të cilësisë dhe ka ngritur një sistemin të menaxhimit të cilësisë.</p> <p>Duke u mbështetur në disa dokumente themelore sic janë Statuti UNYT, Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit dhe Manualit për sigurimin e brendshëm të Cilësisë, etj, ka një sërë parimesh që vendosin mësimdhënien në një pozicion të favorshëm dhe mbështetës për përdorimin e metodave innovative.</p> <p>Sipas manualit të cilësisë, misioni, vizioni por edhe dokumentat e tjerë që lidhen direct me cilësinë (aneks ne raport), UNYT e mbështet punën e vet në shumë tregues që sigurojnë mbarëvajtjen e këtij procesi duke siguruar ndërkohë kreativitetin, lirinë akademike, bashkëpunimin dhe shkëmbimin për kërkimet në shkencë, dhe edukim.</p> <p><i>Annex 3.1_Manual of Instructors</i> <i>Annex 6.18_Teaching and Learning Strategy and Evaluation Methods, Alb</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Cilësisë me monitorim të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë harton pyetësorë për studentët të cilët vlerësojnë instruktorin dhe lëndën të cilën po ndjekin. Këta pyetësorë kryhen normalisht dy herë në vit. Për personelin akademik që jep mësim për herë të parë, vlerësimi nga studentët aplikohet dy herë në semestër. Rezultati i performancës për stafin akademik i vihet në dispozicion rektoratit, dekanëve të fakultetit, departamenteve si dhe instruktorëve përkatës me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe vënien në pah të nevojave dhe sugjerimeve të studentëve.</p> <p>Përveç pyetësorëve të plotësuar nga studentët, Departamenti, duke ndjekur politika të vlerësimit periodik përsa i përket stafit akademik dhe ndihmës-akademik për monitorimin dhe përmirësimin e aftësive të stafit në procesin e mësimdhënies, aplikon edhe mekanizma të tjerë monitorues.</p> <p>Procesi i vlerësimit të kolegëve që ka si synim përmirësimin e aftësive në mësimdhënie.</p> <p>Se fundmi, procesi i vetëvlerësimit perkujdrejt objektivave të vendosura në fillim të vitit akademik, është një mjet për stafin akademik që u lejon atyre të reflektojnë mbi strategjinë e tyre të mësimdhënies dhe të ndërmarrin hapa për t'u përmirësuar</p> <p><i>Annex 1.1_UNYT Statute</i> <i>Annex 6.1_Manual for Internal Quality Assurance</i> <i>Annex 6.2_Annual Report NjSBC 2020-2021</i> <i>Annex 6.2.1_Annual Report NjSBC 2021-2022</i> <i>Annex 6.9_Student Evaluation Form</i> <i>Annex 6.9.1_Evaluation of Academics by Students</i> <i>Annex 6.9.2_E-mail for Evaluation of Academics by Students (Rector, Dean, Head of Department)</i></p>

	<i>Annex 6.9.3_E-mail for Evaluation of Academics by Students (For each professor)</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>I gjithë sistemi është eficientë, i monitorueshëm nga zyrat përgjegjëse dhe i qartë në faktin se kush bën çfarë. Ajo cka është interesante dhe vjen e sugjeruar nga stafet apo edhe vetë NJSBC është se digitalizimi i procesit do të ishte një hap i metejshëm që do të certifikonte cilësinë. Por vlen për t'u theksuar se i gjithë procesi ka patur kohën e vet tashmë për t'u certifikuar dhe për t'u korrigjuar cdo aspekt jo eficient i mundshëm, dhe kjo është siguruar me cilësi për të gjithë dekadat që UNYT është në treg. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit si dhe Njësia për Sigurimin e Cilësisë, si dy njësi të përfshira direct me këtë proces, në kuadër të transparencës së institucionit bëjnë të mundur publikimin e raporteve përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të UNYT.</p> <p>KSC ose Komisioni i sigurimit të cilësisë ka përfaqësues në të gjitha fakultetet, dhe ka edhe një student me detyrën e mbarëvajtjes së cilësisë së mësimdhënies.</p>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Në cilësinë e një Universiteti i cili operon aktivitetin akademik me qendër studentin, UNYT ka zhvilluar online/on site formën e peticioneve/ankimimeve me natyrë akademike dhe administrative në mënyrë që të njihet me pakënaqësitë ose kërkesat e ndryshme të studentëve. Senati Akademik ka ngritur një komision të përhershëm i cili pasi shqyrton vendos për zgjidhjen apo orientimin e duhur të situatave. Për më tepër, UNYT mbështet dhe promovon kërkime shkencore në stafin e saj. Për promovimin e stafit akademik alokohet një buxhet për pjesëmarrjen në konferenca dhe botime nga stafi akademik. Disa nga instrumentat përkatëse për vlerësimet e stafit akademik janë: vlerësimet nga kolegët dhe studentët, takimet e këshillit të fakultetit dhe departamentit, takimet personale me stafin akademik.</p> <p><i>Annex 4.29_Senate Decision No 67/2020 – Staff Promotion</i> <i>Annex 4.29.1_Senate Decision No 75/2020 – Staff Promotion</i> <i>Annex 4.31_Faculty of Economy and Business Budget Plan 2022-2023</i> <i>Annex 4.32_Support for Scientific Activities</i> <i>Annex 5.29_Academic Petition</i> <i>Annex 5.29.1_Petition Decision (Administrative)</i></p>
Konkluzione	<p><i>Për të garantuar cilësinë UNYT në tërësi, por edhe për këtë program studimi ka ngritur dhe konsoliduar prej vitesh tashmë një sistem të tërë kontrolli dhe monitorimi të cilësisë. Për t'a siguruar atë ka përfshirë që nga studentët, stafet akademike dhe jo akademike, drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore përmes proceseve, procedurave dhe raportimeve semestrale apo vjetore. Sugjerohet digitalizimi i këtij procesi nga stafet dhe njësia e sigurimit të cilësisë.</i></p> <p><i>Mbështetet promovimi i praktikave të mira, është i qartë procesi për cdo rast ankimi apo problematikë e cila në fakt ka shumë mundësi që</i></p>

	<i>përmes identifikimit të hallkave të procesit të identifikohet mjaft herët dhe zgjidhet shpejt.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UNYT ka hartuar Strategjinë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit për periudhën 2020-2025 me synim arritjen e objektivit për ekselencë në mësimdhënie dhe përqafimin e epokës së re të edukimit.</p> <p>Përkushtimi ndaj metodologjive të reja të mësimdhënies janë në misionin e institucionit i cili i kushton mjaft rëndësi risive me ndikim mësimor dhe kërkimor. Stafit i Departamentit ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga NjSBC dhe ekspertë të jashtëm për metodat bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe ka nxitur përdorimin më të gjerë të metodave të reja teknologjike.</p> <p>UNYT i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, siç përcaktohet në Statutin e tij (neni 32) dhe Planin Strategjik 2020-2025, (qëllimi strategjik 1), UNYT "<i>përpiqet për përsosmëri akademike në mësimdhënie, bursa dhe shërbime, duke i'u përmbajtur standardeve më të larta të cilësisë në mësimdhënie</i>".</p> <p>Dy strukturat përgjegjëse janë KPSSC dhe NjSBC. Për të mbështetur më tej përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, ka hartuar dhe rregulloren e KPSSC, Manualin e Sigurimit të Cilësisë si dhe Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Keto dy njësi kanë një qëllim të përbashkët sigurimin e cilësisë në UNYT. NjSBC funksionon bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Institucionit, Rregulloret specifike si dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë. KPSSC është institucionalizuar si një strukturë organizative në UNYT përmes ngritjes dhe funksionimit të strukturave të përhershme dhe për sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit. Ky komision është i kompozuar prej 6 anëtarë të stafit akademik dhe një përfaqësues student, i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me NjSBC e cila është e kompozuar me 2 anëtar të stafit administrativ dhe një ekspert i jashtëm me profil akademik.</p> <p><i>Annex 1.1_ UNYT Statute</i> <i>Annex 1.6_ Strategic Plan 2020-2025</i> <i>Annex 6.1_ Manual for Internal Quality Assurance</i></p>

	<p><i>Annex 6.3_ Regulation for the Permanent Quality Assurance and Standards Committee</i></p> <p><i>Annex 6.7_ Regulation for the Internal Quality Assurance Unit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Njësia bazë dhe ajo kryesore bashkëpunojnë intensivisht me aktorët e biznesit si edhe strukturat e tjera publike edhe private duke i përpjekur t'i përfshijne ata në përmirësimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit apo rritjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Instrumenti institucional është Manuali i Sigurimit të Cilësisë, i cili është dokumenti bazë për KPSSC të institucionit. Ky proces sigurohet me mënyra të ndryshme si: peticionet akademike të studentëve, vlerësimi nga studentët, raportet e vetëvlerësimit, vlerësimi i kolegëve nga mbikëqyrësit për çdo profesor. Bazuar në këtë procedurë, ekziston një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet mbikëqyrësit dhe të mbikëqyrurit për të siguruar kontrollin dhe balancat e instrumenteve të sigurimit të cilësisë së UNYT.</p> <p>NjsBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve fillestare dhe periodike, dhe institucionale.</p> <p>Bazuar në nevojat e Institucionit si dhe në kuadër të marrjes së vendimeve sa më objektive dhe efikase, NjsBC bashkëpunon me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë UNYT si dhe një konsulent juridik me qëllim përmirësimin e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Sigurimi i cilësisë është një proces konkret, i matshëm dhe i arritshëm që mundësohet nga procedura, dukumentacione, raporte dhe stafe e studentë. Është një proces i përmirësuar ndër vite dhe i standartizuar tashmë. Pedagogët ju nënshtrohen 4 formave të vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raporti i Vlerësimit të Studentëve, • Raporti i Vlerësimit nga Kolegët, • Raporti i Vlerësimit të performancës Individuale dhe • Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit. <p><i>Annex 1.19_ NJSBC Transparency Assessment Report -2020- 2021</i> <i>Annex 1.19.1_ NJSBC Transparency Assessment Report -2021_ SP22</i> <i>Annex 6.1_ Manual for Internal Quality Assurance</i> <i>Annex 6.9_ Student Evaluation Form</i> <i>Annex 6.9.1_ Evaluations of Academics by Students</i> <i>Annex 6.10_ Individual Performance Assessment Form</i></p>
Konkluzione	<p><i>Strukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë janë tashmë të ngritura dhe certifikuar në shërbimet që ofrojnë. Ajo funksionojnë mbi bazën e politikave përkatëse të institucionit i cili funksionon më tej mbi bazën e rregulloreve dhe zyrave përkatëse përgjegjëse për procesin e sigurimit dhe monitorimit të cilësisë.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>I gjithë procesi i garantimit të cilësisë së këtij programi studimi, por edhe i programeve të tjera në tërësi i UNYT është i garantuar përmes njësive të ngritura që realizojnë dhe mundësojnë të gjithë procesin, mbështeten mbi rregullore në funksionimin e tyre, certifikojnë cilësinë dhe monitorojnë rezultatet duke e garantuar atë.</p> <p>Ky proces koordinohet nga të gjitha strukturat me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara në të gjitha hallkat e procesit. Në fillim të çdo viti akademik kërkohet nga Rektorati të vendosen objektivat personale për secilin staf akademik dhe në nivel Departamenti për plotësim përgjate vitit në vijim. Përgjatë vitit akademik kryhen proceset e nevojshme për përmbushjen e këtyre objektivave nga të gjithë aktorët e përfshirë në proces.</p> <p>Vlerësimi i programit është proces që kryhet periodikisht, kalon në shumë etapa dhe hallka dhe tashmë është institucionalizuar përmes metodologjisë së përdorur.</p> <p>Informacionin që mblidhet nga burime të ndryshme, duke nisur me studentët, pedagogët apo mbledhjet formale, që rezulton si output i procesit dhe që prek dhe përfshin të gjitha hallkat e aktivitetit, institucioni e reflekton përmes procesit të përmirësimit periodik të programit, duke e kthyer këtë proces në një standart dhe instrument vlerësimi.</p> <p>Duke rishikuar programet e lëndëve, metodat dhe elemente të ndryshme të procesit të mësimdhënies, procesi i sigurimit të cilësisë rezulton në një metodë nga poshtë-lart.</p> <p>Njësia bazë departamenti është direkt i përfshirë në procesin e vlerësimit të programeve edhe të cilësisë së mësimdhënies dhe mbarëvajtjes së saj. Kështu, departamenti përdor performancë evaluation që plotësohet nga secili pedagog e bën dhe manaxhon departamenti. Bëhet në fund të çdo viti dhe i bashkangjitet raportit vjetor të departamentit dhe raporteve përkatëse që përdorin edhe zyrat e tjera administrative të lidhura direkt dhe indirekt me cilësinë dhe mësimdhënien.</p> <p>Ne lidhje me rastet me të mira apo praktikë jo të mira mund të thuhet se: Njësia e sigurimit të cilësisë vë në dijeni shefin e departamentit për çdo rast negativ, shefi diskuton me stafin dhe ia shpreh komentet dhe problematikat. Shefi departamentit në varësi të rastit përgat një raport apo e përfshin atë në raportin vjetor. Në këtë mënyrë identifikohen praktikë më të mira dhe promovohen ato më tej, por edhe mundësohen të</p>


	<p>identifikohen dhe parandalohen praktikat e këqija. Ky process bëhet i mundur vecanërisht përmes përfshirjes së studentëve dhe vëmëndjes ndaj stafit të ri.</p> <p><i>Annex 4.29_Senate Decision No 67/2020 Staff Promotion</i> <i>Annex 4.29.1_Senate Decision No 75/2020 Staff Promotion</i> <i>Annex 6.9_Student Evaluation Form</i> <i>Annex 6.9.1_Evaluations of Academics by Students</i> <i>Annex 6.9.2_E-mail for the Evaluation of Academics by Students (Rector, Dean, Head of Department)</i> <i>Annex 6.9.3_E-mail for the Evaluation of Academics by Students (For each professor)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Metodologjia që përdor UNYT në kuadër të realizimit të cilësisë së programit të studimit është e identifikuar dhe cilësore. Kështu mund të përmendim vlerësimin e kurrikulës pasi mund të evidentohet që kanë ndodhur ndryshime bazuar përmirësimet e vazhdueshme të syllabuseve të lëndëve apo metodave të përdorura, të evidentuara në analizat vjetore. Këtu përmenden përdorimi i seminareve akademike, Procesi i Rishikimit të Syllabuseve; Programet e monitorimit, Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi aplikon transparencë të vlerësimit çdo semestër për të identifikuar dhe minimizuar paragjykimet e mundshme gjatë këtij procesi.</p> <p>Gjithashtu, UNYT integron cilësinë e mësimdhënies me politikat e mbështetjes së studentëve nëpërmjet Këshilltarit Akademik, Qendrës së Matematikës, Qendrës së Shkrimit, Qendrës së Mbështetjes dhe Këshillimit Akademik, Zyrës së Pranimi të Studentëve, Dekanit të Studentëve, Zyra e Karrieres dhe Alumnit.</p> <p>Gjithashtu po në menyre direkte, UNYT përdor një sërë mekanizmesh në kuadër të monitorimit dhe përmirësimit të niveleve të cilësisë si: procesi i vlerësimit të studentëve: përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies, si një shtytës i fuqishëm, pasi ata janë përfituesit dhe objektivat kryesore të veprimtarive mësimore të institucionit; Procesi i vlerësimit të kolegëve: ndihmon profesorët të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta, mjetet dhe teknikat e tyre për të përfituar të nxënies e studentëve; procesi i vetëvlerësimit: një mjet për profesorët që u lejon atyre të reflektojnë mbi strategjinë e tyre të mësimdhënies dhe të ndërmarrin hapa për të përmirësuar.</p> <p><i>Annex 3.17_Individual Performance Assessment</i> <i>Annex 2.14_NJSBC Transparency Assessment Report</i> <i>Annex 6.4_Colleague Evaluation Form</i> <i>Annex 6.6_Annual Monitoring Report Form</i> <i>Annex 6.9_Student Evaluation Form</i> <i>Annex 6.9.1_Evaluation of Academics by Students</i> <i>Annex 6.10_Individual Performance Assessment Form</i> <i>Annex 1.22_Proposal on MBA Curricula Revision</i></p>

	<i>Annex 1.23 Confirmation on MBA Curricula Revision Effective for 2023-2024</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	<p>Përvec metodave të drejtpërdrejta, edhe metodat e tërthorta shërbejnë për vlerësimin e realizimit të mbarëvajtjes së cilësisë së këtij programi studimi. Sic u shpjegua edhe në kriteret më lart, sondazhet e studentëve japin rezultat. Gjithashtu bëhen edhe sondazhe të Alumni për të evidentuar rezultatet në tregun e punës.</p> <p>Të gjitha këto metoda që përdor UNYT përbëjnë një metodologji të spikatur dhe mirëcaktuar e cila përmbledh një sërë mekanizmash në kuadër të monitorimit dhe përmirësimit të niveleve të cilësisë si:</p> <p><i>procesi i vlerësimit të studentëve:</i> përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit, si një shtytës i fuqishëm, pasi ata janë përfituesit dhe objektivat kryesore të veprimtarive mësimore të institucionit;</p> <p><i>Procesi i vlerësimit të kolegëve:</i> e organizuar prej vitesh tashmë ka rezultuar mbështetëse e mirë në përmirësimin e procesit mësimdhënës dhe rritjen e cilësisë sepse ndihmon profesorët të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta, mjetet dhe teknikat e tyre për të përfituar të nxënit e studentëve;</p> <p><i>procesi i vetëvlerësimit:</i> një mjet për profesorët që u lejon atyre të reflektojnë mbi strategjinë e tyre të mësimdhënies dhe të ndërmarrin hapa për të përmirësuar cilesine.</p> <p><i>Annex 3.13_Exit Survey</i> <i>Annex 5.14.6_Keynote Speaker</i> <i>Annex 6.15_ASCAL National Student Survey</i></p>			
Konkluzione	<p><i>E gjithë metodologjia e ngritur nga UNYT përmbledh njësinë bazë dhe kryesore përmes një sërë zyrash të ngritura pikërisht për këtë qëllim. Këto zyra kanë përfshirë të gjithë aktorët përmes metodologjisë përkatëse që ka rezultuar pozitive dhe ka dhënë një feed back cilësor në përmirësimet e ardhshme. Kombinimi i metodologjive të drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta janë instrument i duhur cilësor për t'u përshtatur sipas situatave me qëllim që edhe cilësia të garantohet por edhe rasti i mirë të promovohet. Në këtë mënyrë identifikohen praktikat më të mira dhe promovohen ato më tej, por edhe mundësohen të identifikohen dhe parandalohen praktikat e këqija. Ky process bëhet i mundur vecanërisht përmes përfshirjes së studentëve dhe vëmendjes ndaj stafit të ri.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Manuali i sigurimit të cilësisë parashikon të gjitha politikat dhe procedurat e brendshme për sigurimin e cilësisë dhe paraqet gjithashtu aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të interesuar. Ai paraqet rolin e institucioneve drejtuese, si senati akademik, zyra e sigurimit të cilësisë, departamenti dhe fakulteti, si orientuese dhe analizuese të të dhënave të cilësisë apo dhe vendimmarrëse në drejtim të përmirësimit të saj bazuar mbi të dhënat e mbledhura. Gjithashtu paraqet rolin e pedagogëve dhe studentëve si burim të dhënash për evidentimin e arritjeve dhe problemeve gjatë procesit të mësimdhënies. Roli i studentëve u tregua edhe më lart me përmbushjen e detyrimit për plotësimin e sondazheve për studentin.</p> <p>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe performancës së programit të studimit, UNYT përdor të gjitha instrumentet, me studentë, të diplomuar, staf akademik dhe administrativ. Studentët gjithashtu plotësojnë një anketë dalëse pas diplomimit ose ndërprerjes së studimeve. Këto raporte shërbejnë për dy qëllime:</p> <p>a) vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pedagogëve; dhe</p> <p>b) përfshirjen e rregullt të studentëve në përmirësimin e programit të studimit. Nga ana tjetër nje vemendje te vecante zene edhe ALUMNI si aktor thellesor ne terheqjen e opinioneve dhe përfshirjen e tyre ne përmirësimin e cilësisë. Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte të vazhdueshme me Alumn-it e Universitetit te New York-ut si dhe angazhon vazhdimisht Alumnit në evente të ndryshme që organizon universiteti.</p> <p><i>Annex 1.1 Statute</i> <i>Annex 6.1 Manual for Internal Quality Assurance</i> <i>Annex 6.3 Regulation for the Permanent Quality Assurance and Standards Committee</i> <i>Annex 6.5 Rectorate Decision no. 99 - External Expert</i> <i>Annex 6.7 Regulation for the Internal Quality Assurance Unit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Struktura të cilat kanë si synim monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë në UNYT mbështeten në Manualin e Sigurimit të Cilësisë të përpiluar nga anëtarët e KPSSC në bashkëpunim me NjsBC si dhe me ekspertin ligjor në UNYT. Manuali i Sigurimit të Cilësisë në UNYT shërben si rregullator në garantimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p>KPSSC në bashkëpunim me NjsBC ka hartuar nje rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e Komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë si dhe për njësimin e sigurimit të cilësisë. Kjo rregullore është hartuar duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr. 80/2015, datë. 22.07.2015; Neni</p>



	<p>1033 dhe 104, bazuar në Statutin e University of New York Tirana, Neni 32 dhe 33 dhe Manualin e KoGaSC.</p> <p><i>Annex 6.1 _Manual for Internal Quality Assurance</i> <i>Annex 6.2 _Annual Report NjSBC 2020-2021</i> <i>Annex 6.2.1 _Annual Report NjSBC 2021-2022</i> <i>Annex 6.3 _Regulation for the Permanent Quality Assurance and Standards Committee</i> <i>Annex 6.7 _Regulation for the Internal Quality Assurance Unit</i> <i>Annex 6.16 _Annual Plan NjSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>KPSSC dhe NjSBC së bashku janë përgjegjëse për koordinimin e procedurave të përgjithshme për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësisve akademike dhe mbështetëse për studentët në mënyrë që të garantojë pajtueshmërinë e kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar. Në UNYT janë zhvilluar përgjatë 20 viteve mekanizmat e sigurimit të cilësive falë praktikave më të mira të partnerëve institucionalë të krijuara që në çelje të institucionit, të cilat përputhen me praktikat më të mira kombëtare dhe nderkombëtare.</p> <p>Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm garanton dhe respekton integritetin akademik dhe shmang diskriminimet apo pabarazitë. Kjo garantohet nëpërmjet Manualit të cilësisë si dhe formateve të miratuara të pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Miratimi i tyre si edhe marrja përsipër e ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënave personale garantohet si nga departmaneti ashtu edhe nga rregulloret përkatëse.</p> <p><i>Annex 1.15 _Individual Performance Assessment 2020-2021</i> <i>Annex 6.4 _Colleague Evaluation Form</i> <i>Annex 6.9 _Annual Monitoring Report Form</i> <i>Annex 6.9.1 _Student Evaluation Form</i> <i>Annex 6.9.2 _Evaluation of Academics by Students</i> <i>Annex _Individual Performance Assessment Form</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimeve periodike të procesit të akreditimit të programeve të studimit, dhe akreditimit Instituciaonal, një vemendje e veçantë i kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm të ASCAL, plan veprimi i cili percillet tek personat përgjegjës dhe ndiqet hap pas hapi nga KPCCS dhe NjSBC. Ky plan-veprimi është edhe pjesë e raportit vjetor të KPCCS dhe NjSBC.</p> <p>Gjithashtu, në fazën hartimit/rishikimit të programeve të studimit, UNYT në disa raste ka bashkëpunuar me ekspertë të jashtëm të fushës në mënyrë për të ofruar një përfaqje më të përshtatshme me tregun e punës.</p> <p><i>Annex 3.17 _Individual Performance Assessment 2020-2021</i> <i>Annex 6.2 _Annual Report NjSBC 2020-2021</i> <i>Annex 6.2.1 _Annual Report NjSBC 2021-2022</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Permes procedurave dhe metodologjive të ngritura dhe certifikuarat nder vite, UNYT siguron se janë përfshirë të gjitha njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe</i></p>





	<i>masat e marra në vijim të tyre. Institucioni në kuadër të parametrave të cilësisë bashkëpunon ngushtë me ekspertin e jashtëm të angazhuar në UNYT, me KPSSC dhe NjSBC. Për strukturat përkatëse Institucioni ka përcaktuar qartë detyrat konkrete për të gjitha njësitë në Statutin e UNYT.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>UNYT ka parashikuar politika dhe strategji për organizimin dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në dokumentet më të rëndësishëm të tij të cilët janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe gjithë të interesuarit.</p> <p>Në kuadër të transparencës së institucionit UNYT merr masa të vazhdueshme për pasurimin e faqes zyrtare të web-it me publikimin e akteve ligjore më të rëndësishme si dhe rregulloret e programeve në mënyrë që studentët dhe të gjithë të interesuarit të njihen me përmbajtjen e tyre. NjSBC publikon vazhdimisht aktet ligjore në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Annex 1.1 _Statute</i> <i>Annex 1.7 _UNYT Regulation</i> <i>Annex 6.1 _Quality Assurance Manual</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike, duke ja komunikuar stafit por duke i përfshirë si pjesë integrale të Analizave të Veprimtarive Mësimore e Kërkimore të raporteve në nivele njesish baze, kryesore dhe universiteti. Vlerësimet e studentëve përpunohen në mënyrë elektronike dhe konkluzionet si dhe komentet u bëhen publike pedagogëve përkatës pasi lënda të ketë përfunduar plotësisht duke ruajtur konfidencialitetin, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Annex 6.9 _Colleague Evaluation Form</i> <i>Annex 6.9.1 _Annual Monitoring Report Form</i> <i>Annex 6.4 _Student Evaluation Form</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Pëmirësimi i cilësisë përbën një proces i cili i kthyer në një kulturë tashmë ka nevojë të vazhduar për feed back cilësor. UNYT operon me procedurë të sigurimit të cilësisë që ofrojnë transparencë dhe për të gjithë aktorët. Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. Personeli akademik dhe</p>

	administrativ ka një rol kyç në zbatimin e planeve të masave që dalin nga mbledhjet e departamentit dhe fakultetit që parashtrojnë analizat vjetore të bëra.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>UNYT vlerëson dhe favorizon përshkallëzimin e metodikës në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të IAL në këtë drejtim. UNYT është gjithashtu shumë transparente lidhur me çfarëdo informacioni, mase apo aktiviteti që duhet të ndërmeret lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Procesi i mirëmbajtjes, sigurisë dhe rritjes së cilësisë është i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshires. Departamentet, Fakultetet por edhe Komisioni i Përhershëm dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë janë në koherencë për përbushjen e objektivave që si qëllim kanë gjithmonë rritjen e cilësisë, vazhdimësinë e programeve, rritjen e numrit të studentëve dhe përbushjen e misionit të Universitetit.</p> <p><i>Annex 6.2 Annual Report NjSBC 2020-2021</i> <i>Annex 6.2.1 Annual Report NjSBC 2021-2022</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Të gjitha rezultatet që mërr dhe përmbledh NJSBC përfshihen nga kjo njësi në një raport/për cdo semëstër. Kjo do të thotë së studentët dhe stafi i ri janë targeti kryesor përmes së cilit kontrollohet dhe certifikohet cilësia, nga i cili konkludohet për një praktikë të mirë apo jo pozitive dhe promovohen më tej. Prandaj UNYT si pjesë korrekte e procesit të identifikimit dhe monitorimit të kontrollit të cilësisë përfshin edhe informimin e studentëve dhe stafëve të përfshira për tregues të identifikuar nga raportet dhe diskutimet mbi mënyrat e përmirësimeve afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
Konkluzione	<p><i>Politikat dhe procedurat në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e UNYT-së.</i></p> <p><i>Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJSBC dhe njesive te tjera te perfshira ne kete proces nga njera ane, dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik.</i></p> <p><i>UNYT bën publike në web-in e universitetit të gjitha vlerësimet e programeve si dhe vlerësimin për akreditimin institucional dhe vë në dispozicion të gjitha vlerësimet nga ASCAL.</i></p> <p><i>Të gjitha vetëvlerësimet e kryera së bashku me rezultatet e tyre përkatëse për programin, pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit të cilat shoqërohen me një plan veprimi. Procesi i mirëmbajtjes, sigurisë dhe rritjes së cilësisë është i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshires.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Programi Master i Shkencave në Administrim Biznes, ofrohet në 6 profile: a. I Përgjithshëm; b. Menaxhim; c. Menaxhim i Burimeve Njerëzore; ç. Marketing; d. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; dh. Bankë të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "UNYT"

Pikat e forta dhe afirmime:

- Programi MSH në AB ofrohet në gjuhën angleze, duke përbërë një pikë të fortë për studentët, një mundësi për të terhequr dhe patur studentë ndërkombëtarë.
- Emri i mirë dhe qëndrueshmëria në treg e kthejnë reputacionin e UNYT në një vlerë të shtuar edhe për këtë program studimi. Siguri për këtë program studimi përben modelin MBA të UNYT i cili solli një qasje të re në tregun e arsimit të lartë për shkak të modelit të zgjedhur të bazuar në sistemin amerikan, por që në vite dëshmoi koherencë ndaj parimeve të një arsimit cilësor.
- Profilizimi dhe qasja me tregun përbejnë risi për këtë program. Në përputhje të plotësisht të kërkesave të akreditimit të mëparshëm, departamenti që e ofron parashikon disa përmirësime sasiore në ndryshimin e kurrikulave.
- Staf i brendshëm dhe i jashtëm, dhe *qëndrueshmëria* e tij si pjesë e Departamentit të Administrimit Biznesit, pjesa më e madhe e pedagogëve kontribuojnë në mësimdhënie për një periudhë mbi 10 vjeçare, disa prej tyre që nga momenti i themelimit të universitetit, Qëndrueshmëria e stafit krijon një lloj përkatësie, por duhet theksuar gjithashtu që drejtuesit e UNYT kanë ditur të ngrenë marrëdhënie të qëndrueshme dhe me stafin e jashtëm. Kështu, nga 16 pedagogë të angazhuar në mësimdhënie në master të shkencave për vitin 2022-2023, 6 prej tyre janë të kategorisë profesor (duke plotësuar dhe sugjerimin nga akreditimi i mëparshëm). Gjithashtu, vlen të theksohet angazhimi i disa personaliteteve nga industria me eksperiencë shumë profesionale në disa fusha dhe lëndë në zhvillim.
- Staf administrativ në numër të konsiderueshëm në mbështetje të procesit akademik.
- Biblioteka e UNYT dhe koncepti i pasurimit vit pas viti të saj në përputhje, me përditësimin e silabuseve dhe përdorimin e literaturës për studentët në gjuhën angleze.
- Një kulturë e mirëstandartizuar e sigurimit të cilësisë, stafi administrativ dhe akademik i përfshirë në dy njësitë e cilësisë ka një kontribut të drejtpërdrejtë në këtë drejtim.



Pika të dobta:

Numri i studentëve i vogël dhe ajo që duhet theksuar është që numri është në rënie. Por mund të analizohet se ky fenomen është në përputhje me tendencën dhe në universitete të tjera, publike dhe private.



Rekomandime:

Në lidhje me rekrutimin në Departament, ka akoma hapësirë për punësim të pedagogëve me tituj, ndonëse mirëkuptojmë barrierën për shkak të mësimit në anglisht. Përsa i përket numrit të lëndëve që pedagogët mbulojnë, do ishte pozitive një ofertë më e diversifikuar.

Përfshirja e guest speakerave nga bota e biznesit dhe ajo akademike ndërkombëtare përbën pikë të fortë. Por sugjerohet të mbahet niveli i mësimit me staf të jashtëm jo vetëm me emrat më të mirë të fushës përkatëse por me titujt më të lartë akademikë.

Të rishikohet mundësia e shtrirjes së mësimit në më shumë ditë se sa thjesht fundjava pasi konsiderohet shumë intensive në 2 ditë.



Silabuset të përshtaten plotësisht me VKM 41 /2018 në pjesën ku specifikohet metodologjia që përdoret në çdo seminar, të vendosen rastet studimore me literaturën dhe linqet përkatëse, gjithashtu të parashikohen dhe javët/temat në të cilat kanë të fuar në auditor, vizita në biznese/organizata. Gjithashtu, tek silabuset, ka një hapësirë vlerësimi e cila lihet në funksion të autonomisë akademike e tipologjisë së lëndës, sugjerohet të reflektohet ky parim dhe nga Rregulloret institucionale



Conclusions of the evaluation of the second cycle study program The Master of Science in Business Administration program is offered in 6 profiles: a. General; b. Management; c. Human Resources Management; c. Marketing; d. Information Systems Management; dh. Bank offered by the Institution of Higher Education "UNYT"

Strengths and Affirmations:

- The MA program at AB is offered in English, constituting a strong point for students, an opportunity to attract and have international students.
- The good name and stability in the market turn UNYT's reputation into an added value for this study program as well. The security for this study program consists of the MBA model at UNYT, which brought a new approach to the higher education market due to the chosen model based on the American system, but which over the years proved coherence to the principles of a quality education.
- Profiling and access to the market are innovations for this program. In accordance with the completion of the previous accreditation requirements, the department that offers it foresees some quantitative improvements in the change of curricula
- Internal and external staff, and its sustainability as part of the Department of Business Administration, most of the lecturers contribute to teaching for a period of over 10 years, some of them since the university was founded. Staff sustainability it creates a kind of affiliation, but it should also be noted that UNYT leaders have known how to establish stable relations with external staff as well. Thus, out of 16 lecturers engaged in teaching in the Master of Science for the year 2022-2023, 6 of them are of the professor category (complementing the suggestion from the previous accreditation). Also, it is worth emphasizing the commitment of some personalities from the industry with very professional experience in some developing fields and subjects.
- Administrative staff in significant numbers in support of the academic process.
- The UNYT library and its year-by-year enrichment concept in accordance with the updating of syllabuses and the use of literature for students in English.
- A well-standardized culture of quality assurance, the administrative and academic staff involved in the two quality units have a direct contribution in this direction.




Weak points:

- The number of students is small and what should be emphasized is that the number is decreasing. But it can be analyzed that this phenomenon is in line with the trend in other universities, public and private.

Recommendations:

- Regarding recruitment in the Department, there is still room for hiring lecturers with titles, although we understand the barrier due to teaching in English. Regarding the number of subjects that lecturers cover, a more diversified offer would be positive.
- The inclusion of guest speakers from the international business and academic world is a strong point. But it is suggested to maintain the level of teaching with external staff not only with the best names in the relevant field but with the highest academic titles.
- To review the possibility of extending the lesson to more days than just the weekend as it is considered too intensive in 2 days.
- The syllabuses should be fully adapted to VKM 41 /2018 in the part where the methodology used in each seminar is specified, the case studies with relevant literature and links should be set, and the weeks/topics in which they have guests in the auditorium, visits to businesses/ organization. Also, in the syllabi, there is an evaluation space which is left in function of the academic autonomy and typology of the subject, we suggest that this principle be reflected in the institutional regulations



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				
VLERËSIMI TËRËSOR				X

